



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 61/2021 regjistër (JR)
Datë 28.10.2021

Vendim Nr. 7 (JR)
Datë 22.02.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

-- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 22.02.2024, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Daniela Sulaj, prokurore/magjistrate e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 426, datë 27.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 63, 64, 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e marrëveshjeve administrative”; Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Daniela Sulaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores/magjistrate e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*.

2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor, pranë institucioneve kompetente, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilëve rezultoi si më poshtë.

2.1. ILDKPKI-ja, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Daniela Sulaj, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit raportin¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka mosdeklarime/deklarime të pasakta ndër vite*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas primeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ka dërguar raportin², në të cilin ka konstatuar *përshtatshmëri për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj*.

2.3. KLP-ja, pasi kreu vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit

¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 20.11.2018, e ILDKPKI-së, “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Daniela Sulaj, me funksion Prokurore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë”.

² Raporti nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 21.12.2017, të KDZh-së.

nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

3. Komisioni, pasi kreu hetimin e plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përfundim me vendimin nr. 426, datë 27.07.2021, vendosi: *“Shkarkimin nga detyra me funksion prokurorë, aktualisht magjistrate e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Vendimi nr. 426, datë 27.07.2021, i Komisionit është marrë bazuar në nenin 58, germa “c”, si dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet për secilin kriter rivlerësimi, si më poshtë.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

[...] subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

[...] subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 3.408.493 lekësh, për të përballuar blerjen e pasurisë “truall” në datën 02.09.2013 dhe në shumën (-) 1.911.246 lekë, për të përballuar investimin e kryer për shtëpinë e banimit në vitin 2013, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, germa “b” nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

[...] subjekti i rivlerësimit Daniela Sulaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

[...] për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, [...], duke vlerësuar në tërësi burimet që kanë shërbyer për vlerësimin profesional të subjektit dhe bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me dosjet numër 2 (dy) dhe dosjen numër 3 (tre), nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit të subjekti të rivlerësimit

5. Kundër vendimit nr. 426, datë 27.07.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet të cilit i kërkon Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: (i) gjykimin e çështjes në seancë publike; (ii) ndryshimin e vendimit nr. 426, datë 27.07.2021, të Komisionit; si dhe (iii) konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Daniela Sulaj, me detyrë prokurorë/magjistrate e komanduar pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqe me natyrë procedurale, si dhe shkaqe mbi zgjidhjen në themel të çështjes.

³ Raporti nr. {***} prot., datë 17.11.2020, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Daniela Sulaj, për periudhën 08 tetor 2013 - 08 tetor 2016”.

5.1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale që lidhen me procesin e rregullt ligjor, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë si më poshtë.

5.1.1. Vendimi objekt shqyrtimi është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi Komisioni nuk ka vlerësuar drejt tërësinë e provave të administruara që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

5.1.2. Komisioni i ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi në vendim nuk ka respektuar parimin e transparencës, parimin e barazisë, parimin e përgjegjshmërisë dhe të objektivitetit.

5.2. Shkaqet e ankimit mbi themelin e çështjes, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten si më poshtë.

5.2.1. Për pasurinë “truall” me sipërfaqe 226 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, Komisioni ka arritur në një konkluzion të padrejtë, pasi ka konsideruar si të paguar çmimin e rivlerësuar të truallit, në shumën 5.763.225 lekë, më datë 02.09.2013, nuk ka vlerësuar se origjina e truallit rrjedh nga kontrata e premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003 dhe kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2013.

5.2.2. Për investimin e punimeve të shtëpisë⁴ të ndërtuar mbi truallin me sipërfaqe 226 m², Komisioni ka gabuar kur vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë me burime të ligjshme këtë investim të kryer në ndërtimin e shtëpisë private për vitin 2013, në shumën (-) 1.911.246 lekë. Kjo mungesë financiare nuk përputhet me analizën financiare të kryer në Komision për të njëjtin vit, duke krijuar në këtë mënyrë një perceptim të gabuar për publikun në lidhje me sasinë e pamjaftueshmërisë financiare.

5.3. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

5.3.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit, lidhur me: (i) pasivitetin e treguar në ndjekjen e hetimeve të duhura në funksion të zbardhjes së ngjarjes për procedimin penal nr. {***}, datë 11.09.2013; (ii) mosmarrjen e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit për procedimin penal nr. {***}, datë 14.12.2012, si dhe moskryerjen e njoftimit të palëve lidhur me disponimin me vendimin e “pushimit të procedimit penal”, për këtë çështje.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Daniela Sulaj, duke e

⁴ Faza nr. 7 e punimeve për ndërtimin e shtëpisë mbi sipërfaqen “truall”.

shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi për shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 426, datë 27.07.2021, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”) në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
9. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, për kalimin e gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore publike. Për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse do të ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit apo konstatimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes.

9.1. Subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimin se Komisioni në vendimmarrjen përfundimtare nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur provave që lidhen me hetimin dhe vlerësimin në tërësi të kriterit të pasurisë, duke konstatuar gabim gjendjen faktike kryesisht lidhur me transaksionin e përfitimit të truallit me sipërfaqe 226 m², si i vetmi shkak për shkarkimin nga detyra.

9.1.1. Në analizë të këtij shkakut ankimor, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vendimi i Komisionit përmban analizën e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, të cilat janë përmendur dhe analizuar duke u bërë pjesë e vlerësimit të Komisionit. Këto akte janë çmuar sipas bindjes së Komisionit parashikuar në nenin 8 të Kodit të Procedurave Administrative⁵ dhe nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Çdo vendimmarrje e ankimuar e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve të çështjes dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike. Me fjalë të tjera, Kolegji mbi të njëjtat akte shkresore mund të arrijë në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni, pa cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

⁵ Neni 8 i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon: “[...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrative”.

9.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi cenim të procesit të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNj-së, pasi në vendim Komisioni nuk ka respektuar parimin e transparencës, barazisë, përgjegjshmërisë dhe të objektivitetit.

9.2.1. Trupi gjykues konstaton se këtë pretendim subjekti i rivlerësimit e lidh me dy momente: (i) me faktin se Komisioni, në ndryshim nga vendimmarrjet e tjera të të njëjtës trupë gjykuese, nuk ka bërë publike në faqen zyrtare, si dhe në kopjen e vendimit përcjellë subjektit të rivlerësimit, analizën financiare për periudhën 2003-2016 që shoqëron vendimin përfundimtar, duke cenuar parimin e transparencës dhe të barazisë; si dhe (ii) me konkluzionin mbi pamjaftueshmërinë financiare për investimin në shtëpinë private në vitin 2013, të cilin subjekti i rivlerësimit e konsideron alogjik dhe joligjor. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, është përgjegjës për faktin e servirur në publik, kur nuk mbështetet në asnjë akt të administruar gjatë hetimit administrativ.

9.2.2. Për sa i përket momentit të parë, mbi cenimin e parimit të transparencës dhe të barazisë, për mospërfshirjen e analizës financiare të periudhës së rivlerësimit 2003-2016, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, nisur nga fazat e ndryshme të krijimit të pasurisë, ka shoqëruar konkluzionet për çdo pasuri objekt shqyrtimi, sipas vitit të krijimit, të përmbledhura në analizën financiare të strukturuar në formë tabelare⁶. Ndonëse jo në formë tabelare, konstatohet se Komisioni ka përmbledhur në një paragraf rezultatin përfundimtar të analizës financiare për periudhën 2003-2016. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se Komisioni nuk i ka bashkëlidhur vendimit analizën financiare për periudhën 2003-2016, nuk do të thotë se në vendimin e tij ka munguar informacioni i përçuar ndaj publikut, pasi analiza financiare përfundimtare është reflektim i asaj çfarë është pasqyruar gjatë periudhave të veçanta të analizuara, për rrjedhojë mungesa e saj bashkëlidhur vendimit nuk cenon parimin e transparencës dhe të barazisë. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, sipas së cilit Komisioni është përgjegjës për mënyrën se si ka pasqyruar në publik shitblerjen e shtëpisë private në vitin 2013, duke mosreferuar dhe vlerësuar aktet e administruara të depozituara për këtë fakt gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues do të mbaj qëndrim në vijim në vendim në përgjigje të shkaqeve të ankimit të lidhura me këtë pasuri.

9.2.3. Lidhur me cenimin e parimit të përgjegjshmërisë dhe objektivitetit, trupi gjykues konstaton se këtë shkak ankimi subjekti i rivlerësimit e lidh me “Konkluzionin përfundimtar” të pasqyruar në paragrafin 65 të vendimit të Komisionit, sa i përket evidentimit të mungesës së burimit financiar në shumën (-) 1.911.246 lekë, për investimin në shtëpi private, që sipas subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me analizën financiare të bërë nga Komisioni, si edhe me konkluzionin për kriterin e pasurisë të vendosur në paragrafin 54 të vendimit. Konkluzioni

⁶ Shih vendimin e Komisionit: (i) në faqen 17, tabela nr. 2, analiza për mundësitë financiare të investimit për fazën e parë në vitin 2003; (ii) në faqen 18, tabela nr. 3, analiza për mundësitë financiare të investimit për fazën e dytë në 2004; (iii) në faqen 19, tabela nr. 4, analiza financiare e vitit 2006; (iv) në faqen 20, tabela nr. 5, analiza financiare e vitit 2008; (v) në faqet 21-22, tabela nr. 6, analiza financiare e vitit 2009; (vi) në faqet 22-23, tabela nr. 7, analiza financiare e vitit 2010; (vii) në faqen 24, tabela nr. 8, analiza financiare për vitin 2013; (viii) në faqen 26, tabela nr. 9, analiza financiare e datës 21.09.2011; (ix) si dhe në faqet 27-28, tabela nr. 10, analiza financiare për datën 28.08.2015.

i pasqyruar në vendim, sipas subjektit, nuk mbështetet në asnjë akt të administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si i tillë, ky konkluzion ka përçuar një perceptim të gabuar të publiku për sa i takon pamjaftueshmërisë të burimeve financiare. Trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit ka ardhur si pasojë e vlerësimit që ai i ka bërë pasurisë truall dhe shtëpisë të ndërtuar mbi të. Trupi gjykues ka dhënë vlerësimin e tij lidhur me këtë pasuri në vijim të këtij vendimi, dhe arritja në një konkluzion të ndryshëm me Komisionin nuk do të thotë *a priori* që jemi përpara cenimit të parimit të përgjegjshmërisë dhe objektivitetit nga ana e Komisionit.

10. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: -- Aneksin 1 “*Analiza që provon mjaftueshmërinë financiare, për blerjen e truallit shtesë në pjesën takuese të bashkëshortit 1/2 e 117 m², më datë 02.09.2013*” -- për të cilin kërkon marrjen nga Kolegji në cilësinë e provës, si dhe dy akte të tjera: (i) shkresën nr. {***} prot., datë 05.10.2021, “*Kthim përgjigje e Komisionit*”, bashkëlidhur analiza përmbledhëse financiare e Komisionit për periudhën 2003-2016; (ii) kopje e dokumentit nr. {***} prot., datë 16.07.2020, “*Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratave të subjektit për t’u komanduar pranë ILD-së*”, marrë me procesverbalin e datës 27.07.2020, për vënien në dispozicion të këtij akti te subjekti. Trupi gjykues konstaton se dy aktet e fundit të sipërcituara nuk janë depozituar fizikisht bashkëlidhur ankimit, por vetëm janë përmendur në përmbajtjen e tij e, për pasojë, nuk mund t’i nënshtrohen vlerësimit në përputhje me kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012).

10.1. Sa i përket “Aneksit 1”, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit me prapësimet mbi rezultatet paraprake të hetimit ka bashkëlidhur, Aneksin 1 “*Analiza financiare për periudhën 2003-2016, e kryer nga subjekti bazuar në metodologjinë e Komisionit*”. Në këtë analizë, subjekti ka reflektuar ndryshimet në përlllogaritjen e vlerës së truallit për vitin 2013, duke rezultuar me balancë pozitive. Nga analizimi i “Aneksit 1”, depozituar me ankimin, rezulton se kjo analizë është një pjesë e integruar e analizës së përgjithshme të këtyre viteve që subjekti i rivlerësimit e kishte paraqitur me prapësimet mbi rezultatet e hetimit. Vendimmarrja e Komisionit bazohet edhe mbi provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të cilat të analizuara në harmoni me aktet që administrohen në kuadër të procesit hetimor i nënshtrohen vlerësimit prej tij. Komisioni ka përfshirë në arsyetimin e tij në vendim dhe disa elementë të analizës financiare të viteve 2003-2016, për të cilat subjekti nuk paraqiti pretendime, përveç analizës financiar të vitit 2013 që përkon me blerjen e pasurisë truall në datën 02.09.2013. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi që të konsiderojë Aneksin 1 “*Analiza që provon mjaftueshmërinë financiare, për blerjen e truallit shtesë në pjesën takuese të bashkëshortit 1/2 e 117 m², më datë 02.09.2013*”, si pjesë përbërëse e argumenteve të shtjelluara në ankim, lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2013 dhe blerjen e pasurisë “truall”, duke mos ia nënshtrohet vlerësimit, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

11. Për sa arsyetuar e konkluduar më sipër, në kushtet kur nuk janë evidentuar shkelje të rënda procedurale që do të sillnin nevojën e korrigjimit të tyre nëpërmjet debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, si dhe kur akti shkresor i paraqitur me

ankimin⁷ u konsiderua si pjesë e tij, trupi gjykues vlerëson se nuk gjejnë zbatim parashikimet e nenit 51, pika 1 të këtij ligji, për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe vendosi shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

12. Për pasurinë truell me sipërfaqe 226 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë truell në datën 02.09.2013 dhe investimin e kryer për shtëpinë e banimit në vitin 2013, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, germa “b” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën (-) 3.408.493 lekë në datën e blerjes dhe për vitin 2013 në shumën (-) 1.911.246 lekë.
13. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke e konsideruar si të pabazuar në akte dhe provat e administruara, pasi: (i) ka vlerësuar si të paguar, çmimin e rivlerësimit të parashikuar në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.09.2013, në shumën 5.763.275 lekë, për sipërfaqen 226 m²; si dhe (ii) nuk ka marrë në konsideratë origjinën e pjesës takuese të truallit të përfituar nga bashkëshorti, e cila rrjedh nga kontrata e premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003.

13.1. Lidhur me çmimin e truallit dhe mënyrën e likuidimit të tij, trupi gjykues vlerësoi fillimisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit kundër konkluzioneve të Komisionit për pjesën takuese të bashkëshortit të saj dhe vlerën respektive të paguar në shumën 1.000.000 lekë.

13.1.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se Komisioni ka arritur në një konkluzion subjektiv, kur vlerëson se: (i) në kontratën e premtim shitjes nuk rezultoi asnjë parashikim mbi bashkëpronësinë e bashkëshortit të subjektit me vëllain e tij S. S.; (ii) për sa i përket pjesës takuese të bashkëshortit prej 175 m² dhe vlerës respektive të paguar në shumën 1.000.000 lekë, Komisioni i konsideroi ato si të mbetura në nivel deklarativ edhe pse ka pasur dijeni me aktet shoqëruese të pasurisë “truall” dhe argumentet mbështetës për të provuar se personi i lidhur nuk i fitoi i vetëm të drejtat reale mbi pasurinë.

13.1.2. Komisioni në vendim, lidhur me vlerësimin e kontratës së premtim shitjes, ka arritur në konkluzionet se: (i) subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte të drejtat reale të përfituara nga kontrata për premtim shitjeje e pasurisë “truall”, në zbatim të nenit 6⁸ të ligjit nr. 9049/2003, por duke mbajtur parasysh DPV/2004, në të cilën referohet viti 2003 si krijim i pasurisë, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit mbi paqartësinë në deklarin për herë të parë. Si përfundim, mbetet një deklarin i pasaktë ndër vite, i cili nuk sjell penalizimin e subjektit në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (ii) në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve të subjektit për sipërfaqen e përfituar dhe vlerën e pasurisë “truall” në raport me aktet e administruara gjatë hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit sepse: (a) bashkëshorti përfitoi i vetëm të drejta reale mbi pasurinë me

⁷Aneksin 1 “Analiza financiare për periudhën 2003-2016, e kryer nga subjekti bazuar në metodologjinë e Komisionit”.

⁸Neni 6 i ligjit nr. 9049/2003, “Deklarimi i parë”, parashikon: “Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarin, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre”.

sipërfaqe 333 m²; (b) në kontratën e premtim shitjes nuk rezultoi asnjë parashikim mbi bashkëpronësinë e bashkëshortit të subjektit me vëllain e tij S. S., në kuptim të rregullimit ligjor mbi bashkëpronësinë; (c) pretendimi i subjektit për pjesën takuese duhet të ishte i bazuar në aktpjesëtim, i cili për sendet e paluajtshme është parashikuar të bëhet me akt noterial. Për këto arsye, arrin në përfundimin se pretendimet e subjektit në lidhje me pjesën takuese të bashkëshortit prej 117 m² dhe vlerën respektive të paguar në shumën 1,000,000 lekë, mbeten në nivel deklarativ; (iii) në lidhje me provueshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave për pagesën e çmimit, Komisioni vlerësoi se dokumentacioni i paraqitur për të ardhurat e S. S. nuk mori vlerën e provës, për sa nuk u paraqit nga subjekti në formën e kërkuar nga ligji. Komisioni, lidhur me analizën financiare për pagesën e vlerës së truallit në vitin 2003, duke konsideruar të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj, konstatoi se ata kanë pasur mundësi për të përballuar pagesën e shumës 1.950.000 lekë, si dhe për kryerjen e investimeve të tjera në vitin 2003, duke rezultuar me një balancë pozitive.

13.2. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting dhe në deklaratat e interesave private periodike (në vijim DIPP), trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit deklaroi “*truall*” me sipërfaqe 226 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me kontratë premtim shitje në prill 2003, me vlerë 1.000.000 lekë pjesa që i përket bashkëshortit nga vlera totale e blerjes së truallit në shumën 1.950.000 lekë për llogari të tij dhe të vëllait të tij S. S., çmim i cili nuk do të ndryshojë edhe në kohën e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes. Në shtator të vitit 2013 ky “*truall*” është blerë me kontratë përfundimtare të shitblerjes, e regjistruar fillimisht në emër të bashkëshortit dhe vëllait të tij S. S.. Në mars të vitit 2016 është bërë ndarja e pasurisë midis vëllezërve S.. Kjo pasuri është blerë dhe regjistruar në emër të bashkëshortit pas martesës. Si burim për përfitimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat personale të dy bashkëshortëve. Vlera e blerjes së pasurisë në prill 2003 për pjesën e P. S. ishte 1.000.000 lekë, ndërsa në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të blerjes është vlerësuar në vlerën 5.763.275 lekë, 50% për secilin bashkëshort.

13.3. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave private periodike, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003. Kjo pasuri rezulton e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2004, si vijon: “*Tokë e pahipotekuar me sipërfaqe 175 m², blerë në vitin 2003, pranë {***}, Tiranë, vlera e pasurisë 1.000.000 lekë, zotëron ½ e pasurisë*”. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar burimi i krijimit për këtë pasuri.

13.4. Trupi gjykues i Kolegjit, për të vlerësuar pretendimet e sipërcituara të subjektit të rivlerësimit në ankim, analizoi kontratën e premtim shitjes dhe dokumentacionin provues bashkëlidhur saj dhe konstatoi si më poshtë.

13.4.1. Sipas kontratës së premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003, palët kontraktore, premtues shitës trashëgimtarët e familjes H. përfaqësuar me prokurë të posaçme nga S. H. dhe premtues blerës P. S. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në pjesën “Kushtet e kontratës” kanë dakordësuar premtimin për shitjen e truallit me sipërfaqe 333 m², kundrejt çmimit 1.950.000 lekë. Shitësit si kusht kontraktor kanë përcaktuar se ky çmim do të mbetet i pandryshuar edhe në kohën e lidhjes së kontratës për kalimin të pronësisë. Po në këtë pjesë

është përcaktuar se pagesa e shumë së dakordësuar midis palëve kontraktore do të bëhej pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, si fakt që vërteton pagimin e shumë të parashikuar në kontratë. Palët midis tyre kanë marr detyrimin që në momentin e marrjes së aktit të pronësisë të lidhin kontratën për kalimin e pronës së mësipërme.

13.4.2. Me transaksionin bankar të kryer pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë ShA, premtues blerësit kanë debituar në datën 15.04.2003, nga llogaria S. S. (vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), shumë 9.877 paund britanik, duke e kredituar në llogarinë e shitësit S. H. shumë 2.010.000 lekë (e konvertuar me kursin e këmbimit valutor të kohës), e cila rezulton të jetë tërhequr në të njëjtën ditë dhe përputhet me çmimin e përcaktuar në kontratën e premtim shitjes.

13.4.3. Subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ⁹ në Komision dhe në ankim, lidhur me modalitetet e kryerjes së pagesës ka sqaruar se shuma 1.950.000 lekë është kryer me të ardhurat e vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. S. S., që në atë kohë punonte në Mbretërinë e Bashkuar. Bashkëshorti i saj P. S. i ka paguar vlerën takuese të truallit prej 1 milion lekësh vëllait të tij S. S. gjatë vitit 2003, duke u investuar për ndërtimin e themeleve, bodrumit që i takonin pjesës së shtëpisë së z. S. S., nëpërmjet blerjeve në *cash* të materialeve të ndërtimit dhe punimeve respektive, për të cilat nuk dispononte dokumente. Për të mbështetur pretendimet e saj lidhur me mundësinë e z. S. S., subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision në cilësinë e provës lëvizjet e llogarisë bankare të z. S. S.. Sipas *statement* bankare konstatohet se në datën 03.06.2002, në llogarinë nr. {***}, në emër të z. S. S. (vëllai i bashkëshortit të subjektit), në monedhën paund, është transferuar shuma 10.000 paund. Në datën 15.04.2003 në Bankën Amerikane të Shqipërisë, një ditë pas lidhjes së kontratës, nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e z. S. S. është transferuar shuma 9.877 paund, konvertuar në 2.010.000 lekë, në favor të palës premtuese shitëse, z. S. H., si përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve, i cili ka tërhequr shumë 2.007.000 lekë.

Për të provuar të ardhurat e përfituara nga z. S. S., për periudhën 2000-2004, subjekti paraqiti në cilësinë e provave në Komision: (1) akte në gjuhën angleze, emërtuar “I.R.S.A-T.C”; (2) fotokopje *statement* të llogarisë në paund britanik (GBP) në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, të S. S.. Nëpërmjet këtyre akteve, subjekti ka pretenduar se të ardhurat e siguruara nga z. S. S. në Mbretërinë e Bashkuar janë transferuar përgjatë viteve 2002 dhe 2003, në llogarinë nr. {***} e çelur në emër z. S. S., në total në shumë 27.993 GBP ose afërsisht 5.6 milionë lekë.

14. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni, lidhur me provueshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave për pagesën e çmimit të truallit sipas kontratës së premtim shitjes, ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur për të ardhurat e z. S. S. nuk kishte vlerë provuese, për sa kohë subjekti nuk e ka paraqitur atë në formën e kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, duke qenë se nuk u provua burimi i ligjshëm i shumave të transferuara në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, Komisioni konkludoi që çmimi i truallit i përcaktuar në kontratën e premtim shitjes është paguar tërësisht nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e tij, Komisioni, edhe pse e ka njohur faktin e transfertës së shumë prej 2.010.000 lekësh nga S. S. në favor të S. H., ka konkluduar që pagesa e çmimit të kontratës është paguar tërësisht nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në vijim të këtij qëndrimi, Komisioni, për të kontrolluar

⁹ Përgjigjet e subjektit në pyetëtorin nr. 2.

mundësinë e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për pagesën e çmimit të truallit në vitin 2003, kreu analizën financiare të njësisë familjare të subjektit të rivlerësimit deri në momentin e pagimit të çmimit, nga ku i rezultoi se ata kanë pasur mundësi për të përballuar pagesën e të gjithë shumës prej 1.950.000 lekësh.

Trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, bazuar në nenin C, pika 15 e Aneksit të Kushtetutës, vlerësoi se aktet në gjuhën angleze të paraqitura nga subjekti për të provuar të ardhurat e z. S. S. dhe statement të llogarisë në GPB pranë “Intesa Sanpaolo Bank” ShA ishin në formën e kërkuar nga ligji. Nga aktet në fashikull, rezulton se në datën 15.04.2003 në Bankën Amerikane të Shqipërisë nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e z. S. S. është transferuar shuma 9.877 pound, konvertuar në 2.010.000 lekë, në favor të palës premtuese shitëse z. S. H., si përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve, i cili ka tërhequr shumën 2.007.000 lekë.

Në datën 15.04.2003 në Bankën Amerikane të Shqipërisë nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e z. S. S. është transferuar shuma 9.877 pound, konvertuar në 2.010.000 lekë, në favor të palës premtuese shitëse z. S. H., si përfaqësues me prokurë i trashëgimtarëve, i cili ka tërhequr shumën 2.007.000 lekë.

15. Trupi gjykues vlerësoi se këto transaksione bankare të kryera në përputhje me parashikimet e kontratës së premtim shitjes, sipas së cilës pagesa e shumës së dakordësuar midis palëve kontraktore do të bëhej pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, provojnë se pagesa e çmimit të truallit të përcaktuar në kontratën e premtim shitjes është bërë me të ardhurat e vëllait të bashkëshortit, z. S. S.. Për qëndrimin e mësipërm, trupi gjykues, në analizë të akteve shkresore të administruara, shpjegimeve dhe argumenteve të subjektit të rivlerësimit, mbajti në konsideratë dhe provat sa vijon.

15.1. Deklaratën periodike të vitit 2004, në të cilën subjekti ka deklaruar: *“Tokë e pahipotekuar me sipërfaqe 175 m², blerë në vitin 2003, pranë {***}, Tiranë, vlera e pasurisë 1.000.000 lekë, zotëron ½ e pasurisë”*.

15.2. Aktin e planvendosjes së pronës së përfitur, i cili shoqëron kontratën e premtim shitjes së truallit. Ky akt ka shënimin *S. H., i shiti P. dhe S. S., sipërfaqen 333 m²*.

15.3. Kërkesën me nr. {***}, datë 08.11.2006, në emër të z. H. S. dhe kërkesën me nr. {***} prot., datë 08.11.2006, në emër të P. dhe Daniela Sulaj, të paraqitura për legalizim të ndërtimit mbi këtë truall.

15.4. Deklaratën noteriale të personit të lidhur, z. P. S., nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2006, në përmbajtje të të cilës është cituar: *“Në kontratën për premtim shitje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003, blerës i truallit figuroj unë, por në të vërtetë gjysma e këtij truallit i përket babait tim H. S.”*. Sipas deklaramit, akt i cili është afër në kohë me periudhën kur është realizuar kontrata e premtim shitjes dhe kur është bërë vetëdeklarimi i kësaj pasurie pranë ALUIZNI-t, konstatohet se gjysma e truallit 333 m² i takonte z. H. S., babait të personit të lidhur, i cili rezulton të ketë qenë kryefamiljar në trungun familjar të vëllait S. S..

15.5. Kontratën e shitblerjes¹⁰ (pasuri e paluajtshme, tokë truall), me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2013, midis palëve kontraktuese shitëse S. H. si përfaqësues me prokurë të posaçme, me palë blerëse P. S. dhe S. S..

16. Në një vlerësim harmonik dhe logjik të provave dhe fakteve të cituara më lart, trupi gjykues konkludoi se edhe pse në kuptim të rregullimit ligjor, lidhur me bashkëpronësinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me vëllain e tij, z. S. S., në kontratën e premtim shitjes nuk rezultoi asnjë parashikim, subjekti i rivlerësimit arriti të provonte bashkëpronësinë e personit të lidhur/bashkëshortit të saj me vëllain e tij në sipërfaqen e truallit 333 m².
17. Lidhur me pagimin e pjesës takuese të çmimit të truallit nga personi i lidhur, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ajo është bërë nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve për sistemimin e truallit në shumën 1.000.000 lekë. Për të mbështetur këtë pretendim, si dhe për të provuar vërtetësinë e fillimit të fazave të punimeve mbi sipërfaqen “truall”, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision fotot dixhitale satelitore.

Për vlerësimin e këtij shkakut ankimi dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues verifikoi pesë pamjet satelitore të portalit të *Google Earth Pro*, prej nga evidentoi ndryshimet në terren që ka pësuar pasuria e paluajtshme “truall” nga vitet 2003-2007. Nga analiza e tyre u konstatua se: (i) në pamjen e parë filmike, në muajin qershor të vitit 2002, në terren nuk dallohen shenja rrethimi e as evidentime në ndërtim; (ii) në pamjen e dytë, të muajit janar të vitit 2003, nuk ka as ndërtim as rrethim; (iii) në pamjen e tretë, tetor 2004, nga pamjet filmike dallohet formalizimi i parcelës, ende jo e rrethuar me mure e avlli dhe dallohet se ka filluar zbatimin për objektin ndërtimor; (iv) në foton e katërt, në muajin qershor 2007, dallohet se objekti ndërtimor ka përfunduar dhe është mbuluar me çati.

Nga verifikimi i këtyre pamjeve, trupit gjykues i rezultoi se në pamjen e tretë fotografike, sipërfaqja e pronës së pretenduar ka pësuar ndryshime, në sistemimin e tokës dhe në zbatimin e projektit ndërtimor në terren, duke konfirmuar në këtë mënyrë ndryshimet graduale të përmendura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe provuar fillimin e kryerjes së shpenzimeve për këtë sipërfaqe truall, të paktën nga momenti i nënshkrimit të kontratës së premtim shitjes. Gjithashtu, u konstatua se foto dixhitale satelitore e muajit qershor e vitit 2007 tregon përfundimin e ndërtimit, duke përkuar ky moment me atë të vetëdeklaruar për efekt të legalizimit, nga subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur/bashkëshorti i saj dhe babai i tij.

18. Në konsideratë të sa u konstatua më sipër, trupi gjykues i vlerësoi bindëse argumentet mbështetës se personi i lidhur ka paguar pjesën takuese në shumën 1.000.000 lekë, nëpërmjet pagesës së shpenzimeve për sistemimin e truallit dhe ndërtimin e themeleve, njëherazi për të dyja shtëpitë, duke filluar që nga viti 2003. Bazuar në këtë konkluzion, pasi u kontrollua dhe korrigjua analiza e kryer në Komision, në të cilën personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit kishin rezultuar që kishin mundësi të paguanin të gjithë çmimin e truallit, pra, shumën prej 1.950.000 lekësh, trupi gjykues konfirmon mundësinë e tyre për të përballuar me burime të ligjshme pjesën takuese të çmimit në shumën prej 1.000.000 lekësh.

¹⁰ *Fashikulli nr. 1, fq. 15.*

19. Sa i përket shkakut të ankimit dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me mundësinë për të përballuar me burime të ligjshme pagesën e çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes për truallin prej 450 m², rezulton si vijon.

Komisioni në vendim, lidhur me vlerësimin e kontratës së shitblerjes, ka arritur në përfundimin se: (i) nga analizimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri duket qartë qëndrueshmëria për të pasqyruar në çdo fazë të hetimit e deri në seancën dëgjimore gjendjen reale të të drejtave të pretenduara, por se këto deklarime nuk përputhen me dokumentacionin ligjor të administruar nga Komisioni; (ii) subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me blerjen e pasurisë truall prej 450 m² (në pjesën takuese) pa paguar asnjë çmim për të; (iii) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 3.408.493 lekësh, për të përballuar blerjen e pasurisë “truall” në datën 02.09.2013. Për këto arsye, Komisioni ka konkluduar se subjekti është në kushtet e aplikimit të masës disiplinore *shkarkim nga detyra*, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me konkluzionet në vendimin e Komisionit, ka pretenduar se: (i) është përpjekur për të pasqyruar në çdo fazë të hetimit gjendjen reale që në vitin 2003 kur daton origjina e përfitimit të truallit prej 226 m²; (ii) nuk dakordësohet me konkluzionin e Komisionit, pasi pretendon se nuk gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së deklaramit dhe as me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për blerjen e pasurisë truall me sipërfaqe 226 m²; (iii) konkluzioni i Komisionit është i gabuar, pasi nuk mbështetet në fakte dhe prova të administruara, pasi Komisioni nuk ka cituar asnjë dokument apo provë shtesë që të mbështesë konkluzionin se është kryer pagesë tjetër përveç pagesës së kryer në vitin 2003.

20. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me pasurinë objekt shqyrtimi Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, ka konfirmuar pronësinë e bashkëshortit të subjektit, z. P. S., mbi pasurinë “truall” me sipërfaqe 226 m². Referuar dokumentacionit të përcjellë nga kjo agjenci, kjo pasuri rezulton të jetë përfituar nëpërmjet kontratave si vijon:

20.1. Me kontratën e premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003, palët kontraktore, premtues shitës trashëgimtarët e familjes H. përfaqësuar me prokurë të posaçme nga S. H. dhe premtues blerës P. S. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), dakordësojnë premtimin për shitjen e truallit me sipërfaqe 333 m², kundrejt çmimit 1.950.000 lekë.

20.2. Me regjistrimin e pronës dhe lëshimin e certifikatës për vërtetim pronësie në datën 14.08.2013, pala shitëse bëhet pronare e sipërfaqes 450 m² truall dhe nënshkruhet kontrata e shitblerjes (pasuri e paluajtshme, toke truall), nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2013. Shitësi S. H. përfaqësues me prokurë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2006, i familjarëve të familjes H. i kanë shitur blerësve P. S. dhe S. S. (vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), sipërfaqen e regjistruar 450 m².

20.3. Në datën 01.03.2016, midis bashkëpronarëve P. S. dhe S. S. është lidhur kontrata e pjesëtimit të pasurisë të paluajtshme, ku në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria me sipërfaqe 226 m², me nr. {**} pasurie, ndërsa në emër të S. S.

figuron e regjistruar pjesa tjetër e pasurisë me sipërfaqe 224 m², me nr. {***} pasurie, zona kadastrale 8180.

21. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, lidhur me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., trupi gjykues konstaton deklaratimet si vijon.

21.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: **“Truall”, me sipërfaqe 226 m² në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me kontratë premtim shitje në prill 2003 me vlerë 1 milion lekë (pjesa që i përket bashkëshortit nga vlera totale e blerjes së truallit në shumën 1.950.000 lekë për llogari të tij dhe të vëllait të tij S. S.), çmim i cili nuk ndryshon edhe në kohën e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes. Në shtator 2013 është blerë me kontratë përfundimtare të shitblerjes regjistruar fillimisht në emër të bashkëshortit dhe vëllait të tij S. S.. Në mars të vitit 2016 është bërë ndarja e pasurisë midis bashkëshortit dhe vëllait të tij S. S.. Kjo pasuri është blerë dhe regjistruar në emër të bashkëshortit pas martesës. Vlera e blerjes në prill 2003 për pjesën e P. S. ishte 1.000.000 lekë, ndërsa në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të blerjes është rivlerësuar në vlerën 5.763.275 lekë.**

21.2. Gjatë deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave periodike pasurore të vitit 2013, subjekti deklaroi se: [...] *Rivlerësim të truallit të tokës, ku është ndërtuar shtëpia në proces rivlerësimi dhe formalizuar kontrata e shitblerjes së truallit (fillimisht me kontratën e parablerjes), ½ e truallit blerë me S. S., në shumën 5.763.275 lekë, me 50% pjesë takuese. [...].*

22. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare në përgjigje të rezultateve të hetimit paraprak ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikundër dhe në ankim, duke theksuar se Komisioni ka shkelur parimin e objektivitetit të çmuarjes së provave, duke e konsideruar kontratën e shitblerjes të datës 02.09.2013, me sipërfaqe 450 m², të shkëputur nga kontrata e premtim shitjes së datës 14.04.2003, për sipërfaqen 333m², duke i trajtuar si dy sipërfaqe trualli të ndryshme. Ajo ka theksuar se: (i) pasuria “truall” me sipërfaqe prej 450 m² e blerë në vitin 2013 është e njëjta pasuri me atë të premtuar për shitje në vitin 2003, me sipërfaqe prej 333 m². Rritja e sipërfaqes prej 117 m² ka ardhur si rezultat i sistemimit të truallit, që me nisjen e themeleve në vitin 2003, i cili prodhoi kosto të konsiderueshme (shumë më tepër seç ishte planifikuar) dhe për këtë pati dakordësi verbale me palën shitëse, që kur të formalizohej kontrata e shitjes të përfshihej sipërfaqja e shtuar pa rritur çmimin; (ii) çmimi i shitblerjes nuk ka ndryshuar, pavarësisht rritjes së sipërfaqes, pasi ky fakt ka qenë i parashikuar në kontratën e premtim shitjes, në rast të kundërt do të zbatoheshin sanksione kundrejt shitësve; (iii) çmimi i vendosur në kontratë është çmimi i rivlerësimit, i bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 06.03.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark në Republikën e Shqipërisë”, të cilin noteri ishte i detyruar ta vendoste sipas udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar; (iv) në lidhje me analizën financiare, subjekti pretendoi se nëse hipotetikohej do të konsiderohej se ishte kryer pagesë për vlerën e truallit të shtuar prej 117 m², duke e llogaritur atë me çmimin e rivlerësuar prej 30.059 lekësh¹¹ për m², në total në pjesë takuese të bashkëshortit arrin në shumën

¹¹ Çmim i rivlerësimit në vitin 2013.

1.758.452 lekë, përsëri ajo rezulton që kishte mundësi për të paguar atë me burime financiare të ligjshme.

Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë noteriale¹² lëshuar nga përfaqësuesi i shitësve, i cili ka konfirmuar të njëjtat rrethana si subjekti i rivlerësimit për rritjen e sipërfaqes së truallit prej 117 m² dhe se çmimi i shitjes i paguar ka qenë vetëm ai në shumën prej 1.950.000 lekësh, i përcaktuar në kontratën e premtim shitjes. Gjithashtu, ajo ka shpjeguar se të gjitha kostot/taksat për rivlerësimin dhe regjistrimin e truallit në vitin 2013 janë paguar nga vëllezërit S., duke paraqitur si prova tri mandatpagesa të kryera ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme [në vijim ZVRPP] nga personi i lidhur, si dhe aktin e llogaritjes për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme. Shumat e paguara në total nga blerësit përmes tri mandateve janë në shumën 28.212 lekë¹³, sipas vlerës së përllogaritur për rivlerësimin e kësaj pasurie nga kjo zyrë. Subjekti edhe pse konsideron që parashikimet kontraktuale janë të qarta dhe provojnë se nuk ka pasur një pagesë tjetër për truallin në momentin e shitblerjes së tij, sjell në vëmendje që ajo nuk ka qenë palë nënshkruese në asnjë prej kontratave të nënshkruara, por nëse do të kishte qenë kështu do të kishte bërë më shumë kujdes për formulimet e dakordësuara në kontratën e shitblerjes.

23. Trupi gjykues analizoi përmbajtjen e kontratës së premtim shitjes dhe kontratës së shitblerjes, prej nga evidentoi se dy kontratat ishin hartuar në një distancë kohore relativisht të gjatë midis tyre prej dhjetë vitesh, përkatësisht kontrata e premtim shitjes në vitin 2003 dhe kontrata e shitblerjes në vitin 2013. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision rezultoi se me kontratën e shitblerjes shitësit, të përfaqësuar me prokurë nga S. H., bazuar në dokumentacionin “certifikatë për vërtetim pronësie” me datë lëshimi 14.08.2013, janë bërë bashkëpronarë të një sipërfaqe të pandarë toke trualli me sipërfaqe prej 450 m², ndodhur në Tiranë¹⁴. Shitësit e kanë përfituar truallin me sipërfaqen 450 m² një muaj para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe me marrjen e certifikatës, pas përfitimit të të drejtave të plota për pronësinë mbi këtë pasuri, kanë kryer dhe kalimin formal të truallit me sipërfaqe 450 m² për personat e lidhur të subjektit të rivlerësimit P. S. dhe S. S.. Trupi gjykues konstatoi se përmes kontratës së premtim shitjes, shitësit i kishin dhënë blerësve garancinë juridike që në momentin e certifikimit të pasurisë do të ndodhte finalizimi i kontratës së shitblerjes, moment ky që do të konkretizonte të drejtën e disponimit të pasurisë dhe bërtjen pronarë *de jure* për të. Nga verifikimi i kontratës së premtim shitjes¹⁵, rezultoi se pala shitëse kishte parashikuar shitjen e sipërfaqes “truall” prej 333 m², përkundëjt çmimit prej 1.950.000 lekësh. Sipas parashikimit kontraktor ky çmim nuk do të ndryshojë edhe në kohën e lidhjes së kontratës për kalimin e pronësisë. Siç edhe subjekti ka shpjeguar, shkaku i lidhjes së kësaj kontrate ishte krijimi i garancive juridike për shitjen në të ardhmen të pasurisë, për arsye të mosdisponimit të dokumentit të pronësisë nga ZVRPP-ja, nga shitësit e saj. Në pjesën “Sanksione” ishte përcaktuar se: *Në rast se dokumentacioni për tjetërsimin e këtij trualli është i gatshëm dhe*

¹² Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.07.2021.

¹³ Referuar pasqyrës së llogaritjes së rivlerësimit të pasurive të paluajtshme.

¹⁴ Në zonën kadastrale nr. {***}, me nr. pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}.

¹⁵ Me nr. {***} rep., nr. {***} kol., e lidhur në datën 14.04.2003.

shitësit heqin dore nga detyrimi për të bërë aktin publik të shitjes, shitësit i paguajnë blerësit dyfishin e çmimit të truallit dhe vlerën e investimeve të bëra në atë.

Në kontratën e shitblerjes¹⁶, në nenin 2, rezulton se objekti i kontratës është shitja e një pjese të pandarë e një trualli me sipërfaqe 450 m². Në nenin 3 të kontratës “Çmimi dhe mënyra e pagesës” palët kanë përcaktuar se: [...] çmimi i shitjes së truallit do të jetë 13.526.550 lekë, shumë kjo e përlllogaritur sipas rivlerësimit të bërë për tokën truall objekt i kësaj kontrate dhe e pasqyruar në kartelën e pasurisë në seksionin “përshkrim i veçantë”. Shuma e sipërme është paguar e plotë prej blerësve [...]. Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e blerësit”, është parashikuar se: *Blerësit kanë paguar totalisht dhe jashtë kësaj zyre shumë prej 13.526.550 lekësh, çmim ky sipas rivlerësimit të bërë për këtë pasuri.*

24. Në analizë të parashikimeve të sipërcituara kontraktuale, trupi gjykues vlerësoi se palët prej momentit të nënshkrimit të kontratës së premtim shitjes ishin dakordësuar për mosndryshim të çmimit të shitjes së truallit në momentin e kalimit të pronësisë mbi këtë truall, madje duke përcaktuar edhe sanksionin që mund të aplikohet ndaj shitësve në rast të moszbatimit të këtij përcaktimi kontraktor. Sipas sanksionit të parashikuar në këtë kontratë, subjekti ka përlllogaritur në pretendimet e paraqitura në Kolegj se shitësit nëse nuk do të lidhnin kontratën e shitblerjes, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e premtim shitjes, do t'i detyroheshin në vitin 2013¹⁷ personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit t'i paguanin vlerën totale të përbërë nga dyfishi i çmimit të truallit të paguar dhe vlerën përkatëse të investuar mbi këtë truall prej tij, deri në këtë vit¹⁸, e cila do të ishte në total në shumë 15.800.000 lekë. Në kushtet e kontratës së shitblerjes, në asnjë prej neneve të saj, nuk parashikohet ndryshimi i kushteve parakontraktore të kontratës së premtim shitjes, për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi që kontrata e premtim shitjes të merret në konsideratë me të gjitha kushtet dhe sanksionet e relatuara në përmbajtje, duke u vlerësuar bashkarish me kontratën e shitblerjes.

Në një interpretim harmonik dhe të logjikshëm të parashikimeve të kontratës së premtim shitjes me përcaktimet e neneve 3 dhe 6 të kontratës së shitblerjes, trupi gjykues vlerëson se palët në këtë të fundit kanë vendosur çmimin e rivlerësimit të sipërfaqes truall, por pa kryer pagesë përtej çmimit të paguar më herët. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion duke pasur në konsideratë edhe faktin që palët kanë finalizuar me kontratën e shitblerjes kushtet e dakordësuar në kontratën e premtim shitjes në vitin 2003, duke e konsideruar çmimin e rivlerësuar të truallit të vendosur në kontratë, si i rrjedhur nga aktet që kishin realizuar këtë veprim, dhe jo si të ekzekutuar midis tyre. Ky vlerësim i trupit gjykues u bazua duke pasur në konsideratë edhe provat e depozituara dhe shpjegimet e subjektit të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në ankim si vijon.

24.1. Praktikën e ZVRPP-së Tiranë, në të cilën janë pasqyruar veprimet për rivlerësimin e çmimit të truallit si: (i) pasqyra llogaritëse e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme¹⁹; (ii) dy

¹⁶ Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2013, midis palëve kontraktuese shitëse S. H., si përfaqësues me prokurë të posaçme, me palë blerëse P. S. dhe S. S..

¹⁷ Viti kur me kontratën e shitblerjes është bërë kalimi i pronësisë mbi truallin.

¹⁸ $2 \times 1.000.000 \text{ lekë} + 13.800.000 \text{ lekë}$ [investimi i subjektit mbi këtë truall] = 15.800.000 lekë.

¹⁹ Sipas çmimit të përlllogaritur nga ZVRPP-ja, për sipërfaqen 450 m² x 30.059.00lekë/m², çmimi minimal fiskal = 13.526.550 lekë. Vlera në kontratën e shitblerjes e përcaktuar, sipas Udhëzimit nr. 9, datë 25.02.2008, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009, për sipërfaqen 450m² x çmimin minimal fiskal 30.059.00 lekë

mandatpagesa, të kryera pranë Credins Bank të datës 24.07.2013 për A. H., një në shumën 15.562,00 lekë një mandatpagesë të kryer në emër të A. H. në shumën 1.300,00 lekë për llogari të ZVRPP-së Tiranë; (iii) mandatpagesë e datës 07.08.2013, në shumën 11.350,00 lekë, për trashëgimtarët H. dhe për llogari të ZVRPP-së Tiranë. Të gjitha pagesat e mësipërme janë mbuluar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit dhe nga vëllai i tij duke qenë se kjo pasuri prej të paktën 10 vjetësh ishte poseduar dhe gëzuar prej tyre, duke u sjellë si pronar të truallit me sipërfaqe 450 m², përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së truallit më datë 02.09.2013.

24.2. Deklaratën periodike të vitit 2013, në të cilën nga subjekti është deklaruar *rivlerësim të truallit të tokës ku është ndërtuar shtëpia në proces legalizimi dhe formalizuar kontrata e shitblerjes të truallit (fillimisht me kontratë parablerje) - 1/2 e pjesës së truallit të blerë bashkë me S. S.* Po në këtë deklaratë është deklaruar se vlera e rivlerësimit ka qenë në shumën 5.763.275 lekë dhe pjesa takuese në këtë pasuri ka qenë prej 50%. Vlera e rivlerësimit e deklaruar prej subjektit në këtë deklaratë periodike trupit gjykues i rezultoi se rrjedh si diferencë ndërmjet çmimit të rivlerësuar të sipërfaqes truall 450 m² në shumën prej 13.526.550 lekësh, konkretisht vlerës prej 6.763.275 lekësh, si ½ pjesë takuese të personit të lidhur, me vlerën prej 1.000.000 lekësh të deklaruar si të paguar prej personit të lidhur për këtë sipërfaqe në deklaratën periodike të vitit 2004.

24.3. Procesverbalin e datës 08.06.2016 mbajtur pranë ILDKPKI-së, në të cilin subjekti në përgjigje të pyetjes nr. 2, të inspektorit të ILDKPKI-së, lidhur me sa deklaruar në deklaratën periodike 2004, për të sqaruar mospërputhjen e vlerës së truallit të deklaruar në vitin 2004, me kontratën e shitblerjes, në shumën 13.526.550 lekë, ka shpjeguar se: [...] *Nuk kam pasur dijeni pasi kontratat janë firmosur nga bashkëshorti. Çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes është vendosur nga noteri për shkak të rivlerësimit, por pagesa për tokën është bërë në vitin kur është hartuar kontrata e premtim shitjes.*

24.4. Shkresën²⁰ e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave e përcjellë gjatë hetimit administrativ në Komision, në të cilën pasqyrohet se janë verifikuar transaksionet bankare për raportime të kontratave noteriale, që i përkasin subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, por nuk rezultojnë raportime për kryerje pagese për kontratën noteriale të shitblerjes së trualli më datë 02.09.2013²¹, me çmim të deklaruar prej 13.526.550 lekësh. Gjithashtu, nuk ka rezultuar as nga raportimet në banka që nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit të jetë kryer ndonjë transaksion bankar në çmimin e deklaruar në vlerën 13.526.550 lekë të kontratës së shitblerjes, në datën 02.09.2013, as në datë të përafërt me të, duke pasur në konsideratë që në këtë periudhë, referuar udhëzimit nr. 6915/2, datë 30.01.2012, “Mbi proceduat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare te noterit”, çdo pagesë duhet të bëhej nëpërmjet llogarisë së noterit.

: koeficienti e inflacionit 1.13 = 11.970.398.23 lekë. Vlera e tatimit për t'u paguar, nëse rivlerësimi do të kryhej nga ZVRPP-ja, është përlllogarit në shumën 15.561.52 lekë dhe në shumën 1.556,152 lekë, vlera e tatimit kur kryhet nga eksperti përmes aktit të ekspertimit.

²⁰ Kthim përgjigje me nr. {***} prot., datë 13.05.2020.

²¹ Sipas referencës në kthim përgjigjen e DPPP-ja për kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep/kol, nënshkruar para noterit A. V., si dhe palë të tretë porositëse të përfshirë shtetasin S. S..

24.5. Mosvijimin e procedurave për të përfituar titullin e pronësisë mbi truallin, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1038, datë 14.09.2009. Ky vendim, në vijim të aplikimit për legalizim të ndërtimit të paraqitur në vitin 2006 nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit dhe i ati i tij, z. H. S., u kishte njohur atyre përfitimin e parcelës ndërtimore²² prej 500 m². Nëse subjekti do të donte të shmangte një efekt financiar për pagesë shtesë përkundrejt shitësve, për truallin prej 450 m², mund të paguante për të në vitin 2009 vlerën prej 400.000 lekësh të përcaktuar në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Mosvijimi i procedurave për të marrë pronësinë mbi këtë parcelë, dëshmon angazhimin e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit për zbatimin prej tij të detyrimeve të parashikuara në kontratën e premtim shitjes, si dhe besimin për zbatimin prej shitësve të detyrimeve të tyre kontraktore, përfshirë këtu edhe atë për pandryshueshmërinë e çmimit në momentin e finalizimit të shitblerjes së pasurisë truall.

25. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për përfitim pa kundërshpërblim të pjesës takuese të sipërfaqes shtesë trualli, pra, ½ të sipërfaqes prej 117 m², mbi atë të parashikuar në kontratën e premtim shitjes, rezulton si vijon.

Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me blerjen e pasurisë truall prej 450 m² (në pjesën takuese) pa paguar asnjë çmim për të, sikundër nuk u provuan as deklaratimet e subjektit në lidhje me përfitimin e një sipërfaqe trualli shtesë prej 117 m² kundrejt të njëjtit çmim të paguar më parë në kontratën premtim shitje e, për rrjedhojë, sipas tij, analiza financiare e subjektit mbetet e njëjtë.

Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se Komisioni sipërfaqen 450 m² duhet ta konsideronte si të përbërë prej sipërfaqes 333 m² të përcaktuar në kontratën e premtim shitjes të datës 14.04.2003 dhe sipërfaqes së shtuar 117 m² e ardhur me dakordësi me palën shitëse gjatë kontratës së premtim shitjes, pa ndryshuar çmimin, duke u formalizuar në kontratën e shitblerjes. Sipas subjektit, analiza financiare e kryer nga vetë Komisioni nuk është në përputhje me arsyetimin e tij në vendim që për kontratën e premtim shitjes të datës 14.02.2003 nuk ka konsideruar z. S. S. si pjesëtar i ½ sipërfaqe të truallit dhe si kontribuues në pagimin e çmimit prej 1.950.000 lekësh. Subjekti thekson se bazuar në këtë konkluzion përllogaritja e Komisionit duhej të bëhej për shumën që rezulton si diferencë e vlerës 6.763.275 lekë [1/2 pjesë e vlerës shumë 13.526.550 lekë] me vlerën 1.950.000 lekë dhe jo me vlerën 1.000.000 lekë sa është paguar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit. Lidhur me këtë sipërfaqe shtesë, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka shpjeguar se: *[...] Meqenëse investimi për sistemimin e tokës ishte i konsiderueshëm (shumë më tepër seç ishte planifikuar) u negociua në mënyrë verbale me shitësit që të shtohet sipërfaqja e tokës që do të përdorej për ndërtimin me 117m² pa rritur çmimin e shitjes prej 1.950.000 lekësh, në mënyrë që të vendoseshin 2 shtëpi ngjitur me njëra-tjetrën.*

26. Nga analizimi i përcaktimeve kontraktore, trupi gjykues konstatoi si të ndryshuar sipërfaqen e truallit të shitur, nga 333 m² në kontratën e premtim shitjes në 450 m² në kontratën e shitblerjes, pra, me një shtesë prej 117 m² më shumë nga sipërfaqja ekzistuese.

²² Në një sipërfaqe me të madhe se sipërfaqja truall e fituar me kontratën e shitblerjes, pra, se 450 m².

Me kontratën pjesëtim pasurie²³ të paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2016, palët P. H. S. dhe S. H. S. kanë deklaruar dakordësinë për pjesëtimin e pasurisë, sipas planit të rilevimit të hartuar nga topografi. Sipërfaqja prej 450 m² rezulton të jetë ndarë me 226 m² për personin e lidhur/bashkëshortin e subjektit, z. P. S. dhe 224 m² për z. S. S., të cilat rezultojnë se janë regjistruar dhe në kartelat e pasurisë së paluajtshme sipas ndarjes përkatëse.

27. Nga krahasimi i ortofotos së portalit *asig.gov.al* me hartën treguese bashkëlidhur kontratës së shitblerjes me nr. {***}, me sipërfaqe 450 m², të lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, më datë 16.09.2013, evidentohet se ndërtimi shtrihet totalisht mbi sipërfaqen 450 m². U verifikuan pamjet satelitore të portalit të *Google Earth Pro*, në të cilat rezultuan ndryshimet që ka pësuar pasuria e paluajtshme “truall” nga vitet 2003-2007. Prej tyre u konstatua që në vitin 2003 e më pas në vitin 2004 ka një formalizim të parcelës, ende jo e rrethuar me mur e avlli, por duket se ka filluar zbatimi për objektin ndërtimor. Parcela e zënë nga objekti ndërtimor e konfirmuar dhe me pamjet e muajit qershor 2007, sipas aktit të ekspertimit të paraqitur nga subjekti²⁴ dhe ortofotos së portalit *asig.gov.al* tregojnë që ndërtimi ka zënë shumë herët në kohë të gjithë sipërfaqen 450 m², pra, përtej sipërfaqes prej 333 m² të dakordësuar në kontratën e premtim shitjes.

Subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision ka depozituar deklaratën noteriale të të gjitha palëve të përfshira në kontratën e shitblerjes së pasurisë truall, pra, nga përfaqësuesi i palës shitëse, z. S. H., personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, z. P. S. dhe vëllai i bashkëshortit, z. S. S.²⁵. Në këtë akt noterial në mënyrë të përmbledhur deklarohet se me marrëveshje të përbashkët, pas lidhjes së kontratës së premtim shitjes, palët janë dakordësuar që personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit dhe z. S. S. do të përdornin 450 m² në vend të 333 m², për shkak të investimit të konsiderueshëm për sistemimin e tokës dhe për ta bërë atë të përshtatshme për ndërtim, pa ndryshuar çmimin prej 1.950.000 lekësh.

28. Trupi gjykues vlerësoi se në përmbajtjen e kontratës së shitblerjes, në asnjë prej neneve të saj, nuk është referuar që palët nëpërmjet këtij akti po shtonin me 117 m² sipërfaqen e dakordësuar për kundrejt pagimit të një vlere lidhur me të. Në konsideratë të përcaktimeve të kontratës së premtim shitjes dhe kontratës së shitblerjes, si dhe deklarimeve e shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues krijoi bindjen se kjo sipërfaqe është përfituar pa kundërshpërblim, në pasqyrim të rrethanave faktike që lidheshin me sipërfaqen e zënë nga ndërtimi. Deklarata noteriale e palëve nënshkruese të kontratës së shitblerjes së truallit, duket se është në harmoni me dokumentacionin justifikues ligjor të kohës, pra, përcaktimet e kontratës së shitblerjes, pamjet/fotografitë²⁶, si dhe ortofotot²⁷, duke krijuar bindjen për bazueshmërinë e pretendimit të subjektit. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se kontrata e shitblerjes së truallit, datë 02.09.2013, ka finalizuar respektimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e premtim shitjes të vitit 2003, si dhe marrëveshjen verbale të palëve për shtesën e sipërfaqes 117 m², pra, për kalimin të blerësit, tashmë edhe në aspektin formal,

²³ *Fashikulli 1, fq. 25.*

²⁴ *Aktekspertimi i përgatitur nga inxhinier gjeodet P. N., datë 16.07.2021.*

²⁵ *Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.07.2021.*

²⁶ *Që rezultojnë nga Google Earth Pro.*

²⁷ *Të aksesuara në portalin asig.gov.al.*

të sipërfaqes totale të truallit prej 450 m², të cilën e posedonin prej vitit 2003 dhe mbi të cilin janë ndërtuar shtëpitë e tyre.

29. Mbështetur në konkluzionet e paragrafëve 24 dhe 28 më sipër në vendim, trupi gjykues analizoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit nëse ajo dhe personi i lidhur me të kishin mundësi me burime financiare të ligjshme për kryerjen në vitin 2013 të punimeve shtesë në shtëpinë e ndërtuar mbi truallin 450 m², në shumën 450.000 lekë²⁸.

Komisioni në vendim²⁹, për investimin në fazën e shtatë të ndërtimit (rregullime në çati, papafingo) të shtëpisë mbi sipërfaqen 226 m² “truall”, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar kryerjen e investimit për vitin 2013, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën (-) 1.911.246 lekë. Për rrjedhojë, subjekti është gjendur në kushtet e aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika “b” të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me investimin e shtëpisë së banimit në vitin 2013, ka pretenduar se: (i) ka bërë deklarament të mjaftueshëm dhe nuk ka mungesë financiare në lidhje me kryerjen e këtij investimi, pasi vlera e investimit në shumën 450.000 lekë në vitin 2013 e veçuar nuk sjell pamjaftueshmëri financiare; (ii) mungesa financiare e konkluduar nga Komisioni në “konkluzionin përfundimtar” është një konkluzion i pavërtetë në kundërshtim të hapur me aktet dhe provat; (iii) mungesa financiare në fund në vlerën (-) 1.911.246 lekë e konstatuar nga Komisioni, për blerjen e truallit dhe investimin në shtëpi, vjen si rrjedhojë e pasqyrimin në mënyrë të padrejtë si shpenzim për blerjen e truallit për vlerën 5.763.275 lekë më datë 02.09.2013, që ka efektin edhe në analizën financiare për gjithë vitin 2013.

30. Me qëllim analizimin e këtij shkakut ankimi dhe pretendimet e subjektit lidhur me të, trupi gjykues analizoi fillimisht deklaramentet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike të vitit 2013, lidhur me investimin për rregullime në çati, papafingon në shtëpinë e banimit të ndërtuar mbi sipërfaqen “truall”, prej nga u konstatua si më poshtë.

30.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi private banimi me sipërfaqe 190 m² (2 kate mbi tokë) + 85 m² (kat në papafingo) + 85 m² (bodrum) e ndërtuar mbi truallin e mësipërm në rrugën “{***}”, Tiranë, në proces legalizimi. [...] Ndërtimi i shtëpisë ka filluar nga viti 2003 dhe ka vazhduar deri në 2013-n, ndërkohë që është bërë e banueshme që në korrik të vitit 2009. Vlera e investuar nga viti 2003 deri në 2016-n është 15.000.000 lekë. [...].* Rezulton se bashkëlidhur deklaratës së pasurisë subjekti ka përcjellë dhe preventivin e datës 18 dhjetor 2012 për rregullimin e ambienteve të papafingos në shtëpinë e ndërtuar prej personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit, në vlerën totale të punimeve 1.820.000 lekë.

30.2. Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investime, por referuar seksionit “Detyrime ndaj personave juridikë apo fizikë” ka deklaruar kredi për shtëpi në Bankës Kombëtare Tregtare [në vijim BKT], në shumën 11.000 euro.

²⁸ Në fazën e shtatë, subjekti i rivlerësimit ka kryer punime në papafingon e shtëpisë, për të cilat ka shpenzuar vlerën rreth 450.000 lekë, e cila është përfshirë në analizën financiare të vitit 2013.

²⁹ Shih paragrafin 41.2 të vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit Daniela Sulaj.

30.3. Në pyetëtorin standard dhe në pyetëtorin e dytë, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i këtij shpenzimi ka ardhur pasi ka qenë nën pragun e deklarimit të shpenzimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi³⁰ dhe për vitin 2013, ky shpenzim lidhur me investimin ka qenë në shumën 450.000 lekë, duke pasur destinacion rregullimet në çati, vendosjen e dyerve dhe dritareve, ka pasur si burim kredinë BKT dhe të ardhurat nga pagat.

30.4. BKT-ja ka konfirmuar se me kontratën e kredisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2013, është përfituar kredi në shumën 11.000 euro. Sipas aneksit bashkëlidhur kontratës së kredisë bankare, kredia ka pasur si objekt rregullim shtëpie. Kredia është disbursuar në datën 27.05.2013 dhe kjo shumë është tërhequr me pjesë, në *cash*, nga personi i lidhur gjatë të njëjtit vit.

- 31.** Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe referuar analizës së Komisionit për ndërtimin e shtëpisë private të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, investimi i personit të lidhur në ndërtimin e shtëpisë 3-katëshe ka kaluar në shtatë faza të ndryshme. Nga analiza e kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar se kanë pasur burime financiare të ligjshme për të përballuar investimin e kryer për ndërtimin e shtëpisë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, përveç vitit 2013 ku subjekti ka rezultuar në pamundësi financiare në shumën (-) 1.911.246 lekë, për të përballuar investimin në shumën prej 450.000 lekësh dhe blerjen e truallit me burime të ligjshme të ardhurash.
- 32.** Trupi gjykues, në analizë të akteve të sipërcituara, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, si në deklaratën periodike të vitit 2013, ashtu dhe në aneksin e kontratës së kredisë bankare, ka identifikuar si burim të shpenzimeve të kryera për rregullimin e shtëpisë, në vitin 2013, kredinë e përfituar në BKT. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni verifikimin mbi ligjshmërinë e burimit dhe mundësinë për kryerjen e investimit në shtëpi në shumën prej 450.000 lekësh, në vitin 2013, duhej ta bazonte në provat e sipërcituara dhe jo si rrjedhojë e një analize financiare për këtë vit. Në këto kushte, trupi gjykues konkludoi që kredia e përfituar nga BKT-ja përmbush kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si një burim i ligjshëm, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit ka justifikuar me burime financiare të ligjshme investimin e kryer për punime shtesë në vitin 2013, në shumën prej 450.000 lekësh.

Konkluzioni i Komisionit, për mungesë burimesh financiare të ligjshme për kryerjen e investimit dhe blerjen e truallit në vitin 2013 në shumën 1.911.246 lekë, rezultoi i pabazuar për trupin gjykues, pasi në analizën e Komisionit u reflektuan konkluzionet e paragrafëve 24 dhe 28 të këtij vendimi. Trupi gjykues vlerësoi në përfundim se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kishin mundësi me burime financiare të ligjshme për kryerjen e investimit për shtëpinë në këtë vit, në shumën 450.000 lekë.

Pavarësisht konkluzionit të trupit gjykues, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë pagesë shtesë për sipërfaqen takuese të truallit prej 58,5 m² [1/2 e 117 m²], në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se përsëri hipotekisht kishte mundësi me burime financiare të ligjshme të paguante këtë sipërfaqe shtesë, si në vitin 2003 apo 2013, Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj kreu analizën për vitet 2003 dhe 2013, pra, edhe në versionin që

³⁰ Në këtë vit pragu i shpenzimeve ka qenë deri në 500.000 lekë.

subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur kanë paguar çmimin për sipërfaqen shtesë të mësipërme. Në vitin 2003, referuar vlerës së kontratës së premtim shitjes prej 1.950.000 lekësh, u përcaktua çmimi për metër katror $1.950.000 \text{ lekë} / 333 \text{ m}^2 = 5.856 \text{ lekë për m}^2$. Pjesa takuese e sipërfaqes shtesë të personit të lidhur prej $58,5 \text{ m}^2$ u llogarit në vlerën 342.567 lekë ($58,5 \text{ m}^2 * 5.856 \text{ lekë}$). Analiza e vitit 2003, për të gjithë pjesën takuese të truallit 226 m^2 përfshirë këtu edhe shtesën e truallit prej $58,5 \text{ m}^2$, rezultoi në vlerë pozitive 1.920.513 lekë. Në vitin 2013, referuar vlerës së rivlerësimit dhe sipërfaqes së truallit në kontratën e shitblerjes prej 13.526.550 lekësh, u përcaktua çmimi për metër katror $13.526.550 \text{ lekë} / 450 \text{ m}^2 = 30.059^{31} \text{ lekë m}^2$. Pjesa takuese e sipërfaqes shtesë të personit të lidhur prej $58,5 \text{ m}^2$ u llogarit në vlerën 1.758.452 lekë ($58,5 \text{ m}^2 * 30.059 \text{ lekë}$). Analiza e vitit 2013 rezultoi në vlerë pozitive 2.093.577 lekë. Pas korrigjimit të analizës së Komisionit si më sipër, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të përballuar me burime të ligjshme financiare blerjen e pjesës takuese të sipërfaqes së truallit prej $58,5 \text{ m}^2$, si në vitin 2003 kur është nënshkruar kontrata e premtim shitjes, ashtu dhe në vitin 2013 kur është formalizuar kontrata e shitblerjes.

33. Në përfundim, në analizë të shkaqeve të ankimit dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë, kryer investime dhe shpenzime për vitin 2013. Për sa më sipër, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur në nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

C. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

34. Nga vlerësimi i përgjithshëm, Grupi i Punës i KLP-së arriti në përfundimin se nuk rezultuan indicie të tjera për hetime të mëtejshme, në kuptim të vlerësimit të aftësive profesionale. Komisioni në vendim, gjatë vlerësimit në mënyrë të pavarur të kriterit të aftësive profesionale, bazuar në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore, mbi të cilat është hartuar raporti, në përfundim, evidentoi gjetje që lidhen me dy dosje nga aktet e shortuara. Dosja nr. 2, për procedimin penal nr. {***}, datë 11.09.2013 dhe dosje nr. 3, për procedimin penal nr. {***}, datë 14.12.2012 dhe arriti në konkluzionin se gjetjet e konstatuara në lidhje me këto çështje nuk janë në atë masë sa të cenojnë nivelin profesional të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, parë kjo nën dritën e tërësisë së burimeve të rivlerësimit.

34.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton arsyetimin dhe përfundimin e Komisionit në vendim, lidhur me veprimet e mosveprimet e kryera në: (i) ndjekjen e hetimeve të duhura në funksion të zbardhjes së ngjarjes për procedimin penal nr. {***}, datë 11.09.2013 dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve përkatës; (ii) procedimin penal nr. {***}, datë 14.12.2012, pasi nuk ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimit dhe nuk ka kryer njoftimin e palëve lidhur me disponimin me vendimin e “Pushimit të procedimit penal” për këtë çështje.

35. Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këto çështje edhe pse Komisioni, pavarësisht konstatimeve në arsyetimin e vendimit, nuk i ka

³¹ Çmim i njëjtë me çmimin e referencës për m^2 , sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 6.03.2013 dhe akteve nënligjore në fuqi. Vlera e tokës truall për vitin 2013 përcaktohet sipas vlerave të përcaktuara në hartën e vlerës së qytetit Tiranë 2012.

konsideruar ato me peshë në vendosjen e masës disiplinore, sipas nenit 61, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016. Pas shqyrtimit të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, të pretendimeve e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me procedurat e ndjekura prej saj si prokurore e çështjeve, trupit gjykues i rezultoi si vijon.

35.1. Procedimi penal nr. {***}, datë regjistrimi 11.09.2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar pas kallëzimit të një shtetasi anglez i quajtur M.D.E.W ndaj shtetasit E. D. në lidhje me disa veprime të paligjshme të kryera nga ky i fundit gjatë kohës së ekzistencës së sipërmarrjes tregtare midis tyre, ku ka referuar midis të tjerave edhe disa fakte mitëmarrjeje ku përfshihen zyrtarë të lartë si z. E. H., në lidhje me favorizimin për marrjen e licencës për krijimin e një resorti turistik në Gose të Kavajës. Për këtë procedim, subjekti i rivlerësimit në datën 27.05.2014 ka vendosur “Pushimin e procedimit penal”.

35.1.1. Komisioni nga analizimi i materialit hetimor evidentoi qëndrimin pasiv të subjektit në drejtim të kryerjes së veprimeve të plota hetimore për zbardhjen e fakteve të tjera penale të referuara në kallëzim ndaj subjekteve të posaçëm, funksionarë të lartë të shtetit, fakte të cilat për nga rëndësia përfshihen në kategorinë e krimeve kundër autoritetit të shtetit, parashikuar në nenin 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë”; nenin 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, si dhe nenin 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë” të Kodit Penal.

35.1.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim, sikundër dhe në prapësimet e saj në përfundim të rezultateve të hetimit, ka dhënë të njëjtat argumente dhe shpjegime lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 11.09.2013, duke theksuar se janë kryer të gjitha veprimet hetimore pa u limituar në faktin penal të mashtrimit, por nga hetimi nuk ka rezultuar konsumimi i elementeve të kësaj apo një tjetër veprë penale.

35.1.3. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se për sa i përket vlerësimit të procedimit penal nr. {***}, datë 11.09.2013, nga aktet e administruara në fashikullin penal, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është ngarkuar për hetimin e këtij procedimi penal, pasi kishin kaluar gjashtë muaj nga data e regjistrimit të kallëzimit penal, për veprën penale të “Mashtrimit” të parashikuar në nenin 143 të Kodit Penal. Referuar këtyre akteve, subjekti i rivlerësimit sapo ka marrë materialin kallëzues ka urdhëruar menjëherë, brenda ditës, regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Mashtrimit”. Regjistrimi i procedimit për këtë veprë penale është bërë nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç edhe ishte referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë. Pavarësisht sa më sipër, rezultoi se në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit, si prokurore e çështjes, ka arsyetuar se do të grumbulloheshin të dhëna të nevojshme për përcaktimin e drejtë të faktit dhe veprës penale, duke mospërshtetur hetimin për ekzistencën e veprave të tjera penale. Në urdhrin e delegimit për kryerjen e veprimeve hetimore, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka shtrirë hetimin për identifikimin e çdo veprimtarie të mundshme të kundërligjshme, përfshirë këtu edhe atë që mund të ishte kryer nga funksionarët publik.

35.1.4. Nga analiza e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë procedim penal, rezultoi se subjekti ka urdhëruar: (i) kërkimin e informacionit në QKB në lidhje me regjistrimin e shoqërisë dhe gjendjen aktuale; (ii) kërkimin e informacionit nga banka

për tërheqjen e shumës së parave nga shtetasi M.D.E.W; (iii) kërkimin e informacionit Ministrisë së Transporteve për pamjet filmike, ku zyrtari i lartë në kohën e referuar ka pasur detyrën e zëvendësministrit të kësaj ministrie; (iv) këqyrjen e librit të hyrje-daljeve të personave në Ministrinë e Jashtme, për periudhën e referuar nga kallëzuesi, ku zyrtari i lartë ka pasur detyrën e Ministrit të kësaj ministrie; (v) administrimin e tabulateve telefonike nga shoqëritë e telefonisë celulare; (vi) marrjen në pyetje të shtetasve E. D. dhe E. H. etj. Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer drejtpërdrejt disa veprime hetimore, si pyetja prej saj personalisht e shtetasit të huaj dhe e funksionarit publik për hetimin e faktit dhe veprës penale të dyshuar. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer veprimet hetimore, ka arritur në përfundimin se të dhënat e mbledhura nuk janë të mjaftueshme për të provuar konsumimin e elementeve të ndonjë prej veprave penale të kallëzuara, si rrjedhim ka vendosur pushimin e çështjes për veprën penale të “Mashttrimit” ndaj shtetasit E. D., me arsyetimin se nuk provohet ana objektive e kësaj vepre penale.

35.1.5. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, të cilat mund të hidhnin dritë mbi sa pretendohet në kallëzimin penal e dyshohet nga organi i akuzës. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar në mënyrë të logjikshme kryerjen e gjithë veprimeve hetimore të nevojshme, të cilat ishin edhe të mundshme të realizoheshin, duke pasur në konsideratë faktin që kishte kaluar mbi dy vjet nga momenti që pretendohet se kishte ndodhur fakti i kallëzuar dhe kur ishte depozituar kallëzimi penal, si dhe kohën/momentin kur kallëzimi i kishte kaluar për verifikim dhe hetim subjektiv të rivlerësimit. Argumentet e subjektivit të rivlerësimit për moskryerjen e një veprimi hetimor të ballafaqimit ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit, si një veprim jo produktiv u gjenden të drejta, logjike dhe bindëse për trupin gjykues, në kushtet kur këta të fundit ishin të përfshirë në një konflikt gjyqësor civil ndërmjet tyre me objekt “Kërkimin e vlerës së parave objekt hetimi”.

Në këto kushte, trupi gjykues i vlerësoi të drejta pretendimet e subjektivit të rivlerësimit në ankim në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 11.09.2013 dhe jo të bazuara konkluzionet e Komisionit për këtë çështje penale në vendim.

35.2. Procedimi penal nr. {***}, datë 14.12.2012, i regjistruar me kallëzimin e disa qytetarëve, ndaj mjekut kardiolog E. P., me detyrën e Shefit të Shërbimit të Kardiologjisë të QSUT-së “Nënë Tereza”, të cilët kanë pretenduar se për kryerjen e operacioneve ky shtetas iu kërkonte shpërblim në para. Për këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit në datën 09.10.2013 ka vendosur “Pushimin e procedimit penal”. Ajo kundërshton konkluzionet e Komisionit se nuk ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve lidhur me këtë procedim penal e që ka qenë pasive në kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe që nuk ka njoftuar palët për vendimmarrjen e saj për pushimin e procedimit penal.

35.2.1. Komisioni gjatë analizës së dosjes penale konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka disponuar për zgjatjen e afateve hetimore, bazuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale, pasi kohëzgjatja e veprimeve hetimore, nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi, ka qenë rreth 10 muaj. Nga analizimi i dosjes, në lidhje me kohëzgjatjen e veprimeve hetimore, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit penal në ngarkim të shtetasit E. P. në datën 14.12.2012, ka nxjerrë urdhrin e delegimit për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficerët e policisë gjyqësore, që kishin

referuar materialin kallëzues, të cilat janë kryer për një periudhë 3-mujore. Sipas Komisionit, prej muajit prill të vitit 2013 deri në datën 23.09.2013, kur është përgatitur relacioni i oficerit të policisë gjyqësore me sugjerimin mbi përfundimin e hetimit, nuk është kryer ndonjë veprim hetimor nga subjekti i rivlerësimit. Mbi sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka vijuar të kryejë veprime hetimore jashtë afatit procedural, parashikuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve.

Komisioni lidhur me këtë procedim ka konkluduar, gjithashtu, se në lidhje me njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka disponuar në vendim për detyrimin e njohjes të palëve të interesuara, por ky vendim nuk duket se i është njoftuar palëve, pasi në fashikullin e procedimit penal nr. {***} nuk rezulton të ketë njoftim në formën e kërkuar nga ligji procedural penal.

35.2.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim i konsideron si të pabazuara gjetjet e Komisionit në vendim, duke paraqitur të njëjtat argumente si në shpjegimet e depozituara në përgjigje të rezultateve të hetimit, si vijojnë.

35.2.2/1. Pas regjistrimit të procedimit penal, mbi bazën e materialit kallëzues të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, edhe pse informacioni i përcjellë mbante vetëm informacionin e referimit të policisë pa u shoqëruar me akte mbështetëse, subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar procedimin penal, pa regjistruar emrin ndaj personit për të cilin janë ngritur akuzat dhe ka hetuar në drejtim të faktit nëse është konsumuar vepra penale e korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

35.2.2/2. Afati i hetimit paraprak fillon të ecë nga momenti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, ndaj nuk ka qenë e nevojshme zgjatja e afateve hetimore. Në referim të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. {***}, regjistrimi i emrit dhe ndryshimi i statusit të personit të cilit i regjistrohet emri mbetet në çmim të prokurorit.

35.2.2/3. Mosnjoftimi i vendimit të pushimit të procedimit penal, palëve të përfshira në proces, ka ardhur duke pasur parasysh faktin se procedimi penal është regjistruar mbi bazën e informacionit të referimit të paraqitur kryesisht nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, si dhe duke qenë se hetimi dhe relacioni për pushimin e procedimit ishte bërë nga oficeri i policisë gjyqësore që kishte referuar materialin kallëzues.

35.2.3. Trupi gjykues në Kolegj, *së pari*, vlerësoi se për sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me fillimin e afateve për kryerjen e veprimeve hetimore, në nenin 287, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet: *“Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale”*, si dhe në nenin 323, pika 2, të po këtij Kodi përcaktohet: *“Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi”*.

Nga analiza e akteve të administruara në fashikullin e këtij procedimi penal, rezulton se shtetasit E. P. nuk i është regjistruar emri në regjistër si personi të cilit i atribuohet vepra penale në kuptim të nenit 287, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë trupi gjykues vlerëson

se nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 323, pika 2 e këtij Kodi, dhe e konsideron të drejtë e të bazuar në ligj pretendimin e subjektit të rivlerësimit që si prokurore e çështjes nuk ka pasur detyrimin për të disponuar me vendim për zgjatjen e afateve të hetimit.

35.2.4. Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, për arsyet e moskomunikimit të vendimit të pushimit të procedimit penal, konstatoi se subjekti i rivlerësimit në dispozitiv të vendimit të pushimit ka cituar se: *“Të njoftoj me këtë vendim personat e interesuar të cilët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose tek Prokurori më i lartë”*. Sipas nenit 328, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale përcaktohet: *“Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”*. Bazuar në këtë parashikim ligjor, subjekti i rivlerësimit në vendimin e pushimit të procedimit penal ka disponuar për njoftimin e këtij vendimi personave të interesuar lidhur me këtë kallëzim, që në rastin konkret ishte Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, e cila kishte referuar materialin kallëzues. Trupi gjykues vlerësoi se procedurat për realizimin e njoftimit lidhur me vendimin e pushimit të procedimit penal, në këtë rast, ndiqeshin nga oficerët e policisë gjyqësore të kësaj drejtorie policie, të cilët kishin kryer edhe veprimet hetimore për materialin kallëzues, për rrjedhojë njoftimi ishte realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me nxjerrjen e vendimit të pushimit, bazuar në relacionin e përgatitur prej tyre.

Sa i përket njoftimit të shtetasit B. Sh., trupi gjykues, nga aktet e administruara në fashikullin e këtij procedimi penal, konstatoi si vijon:

- a) Shtetasi B. Sh. ka qenë në cilësinë e kallëzuesit pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, e cila referoi materialin kallëzues, siç është trajtuar më sipër në këtë vendim, dhe bazuar në të cilin subjekti i rivlerësimit regjistroi procedimin penal për “Korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”.
- b) Shtetasi B. Sh. kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi me organin procedues, për gatishmërinë e tij, për kryerjen e përgjimeve të bisedave ambientale dhe telefonike me shtetasin E. P..

Në konsideratë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se shtetasi B. Sh., në kuadër të këtij bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, duhet të njoftohej prej këtij organi mbi vijueshmërinë e hetimit nga organi i akuzës dhe mënyrën e përfundimit të tij, pra, për vendimin e pushimit të procedimit penal.

Në këto kushte, trupi gjykues i vlerësoi të drejta pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 14.12.2012 dhe jo të bazuara konkluzionet e Komisionit për këtë çështje penale në vendim.

36. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i vlerësoi të drejta pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, për procedimet penale nr. {***}, datë 11.09.2013 dhe nr. {***}, datë 14.12.2012, duke konfirmuar të njëjtin qëndrim si dhe Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

37. Mbështetur në sa më sipër, në konsideratë të konkluzioneve të Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës dhe nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të konkluzionit të arritur në paragrafin 33 të këtij vendimi, për nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e përcaktuara të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ndaj, në këto rrethana, vendimi i Komisionit duhet ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 426, datë 27.07.2021 dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Daniela Sulaj.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 22.02.2024.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares/kryesueses së trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 07, datë 22.02.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 426, datë 27.07.2021, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Daniela Sulaj.*
2. Nga analizimi i çështjes në tërësi, bazuar në aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore në kuadër të shqyrtimit të kësaj çështjeje, paraqitet kjo situatë faktike, për të cilën, unë gjyqtare në pakicë, jam kundër vendimmarrjes së shumicës së trupit gjykues, dhe më konkretisht:

Për pasurinë truall me sipërfaqe 226 m², ndodhur në rrugën “{}”, Tiranë***

3. Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë truall në datën 02.09.2013 dhe sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, germa “b” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën (-) 3.408.493 lekë.*
4. Shumica e trupit gjykues në Kolegji, për këtë pasuri, ndër tjera, ka konkluduar se:

“[...] në përmbajtjen e kontratës së shitblerjes, në asnjë prej neneve të saj, nuk është referuar që palët nëpërmjet këtij akti po shtonin me 117 m² sipërfaqen e dakordësuar përkundrejt pagimit të një vlere lidhur me të. Në konsideratë të përcaktimeve të kontratës së premtim shitjes dhe kontratës së shitblerjes, si dhe deklarimeve e shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues krijoi bindjen se kjo sipërfaqe është përfituar pa kundërshtim, në pasqyrim të rrethanave faktike që lidheshin me sipërfaqen e zënë nga ndërtimi. Deklarata noteriale e palëve nënshkruese të kontratës së shitblerjes së truallit, duket se është në harmoni me dokumentacionin justifikues ligjor të kohës, pra, përcaktimet e kontratës së shitblerjes, pamjet/fotografitë si dhe ortofotot, duke krijuar bindjen për bazueshmërinë e pretendimit të subjektit. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se kontrata e shitblerjes së truallit datë 02.09.2013, ka finalizuar respektimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e premtim shitjes të vitit 2003, si dhe marrëveshjen verbale të palëve për shtesën e sipërfaqes 117 m², pra, për kalimin të blerësit tashmë edhe në aspektin formal, të sipërfaqes totale të truallit prej 450 m² të cilën e posedonin prej vitit 2003, dhe mbi të cilin janë ndërtuar shtëpitë e tyre”.

5. Për mua si gjyqtare në pakicë, situatat faktike dhe ligjore të kësaj çështjeje nuk mbështesin vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues. Referuar akteve shkresore të dosjes gjyqësore, rezulton se:

5.1. Nëpërmjet kontratës së premtim shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2003, palët kontraktore, premtues shitës trashëgimtarët e familjes H., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga z. S. H. dhe premtues blerës P. S. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), kanë dakordësuar premtimin për shitjen e truallit me sipërfaqe 333 m², kundrejt çmimit 1.950.000 lekë, çmim i cili, sipas kushteve të kontratës, nuk do të ndryshojë edhe në kohën e lidhjes së

kontratës përfundimtare për kalimin e pronësisë. Sipas kësaj kontrate, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, përfitoi i vetëm të drejtat reale mbi pasurinë *truall*.

5.2. Kjo e drejtë reale e përfituar sipas kontratës së premtim shitjes nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, është deklaruar: *“Tokë e pahirpotekuar me sipërfaqe 175 m², blerë në vitin 2003, pranë {***}, Tiranë, vlera e pasurisë 1.000.000 lekë, zotëron ½ e pasurisë”*. Në këtë deklarim periodik, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

5.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarohet nga subjekti i rivlerësimit: *“Truall me sipërfaqe 226 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me kontratë premtim shitje në prill 2003, me vlerë 1.000.000 lekë (pjesa që i përket bashkëshortit nga vlera totale e blerjes së truallit në shumën 1.950.000 lekë për llogari të tij dhe të vëllait të tij S. S.), çmim i cili nuk do të ndryshojë edhe në kohën e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes. Në shtator të vitit 2013 është blerë me kontratë përfundimtare të shitblerjes e regjistruar fillimisht në emër të bashkëshortit dhe vëllait të tij S. S.. Në mars të vitit 2016 është bërë ndarja e pasurisë midis bashkëshortit dhe vëllait të tij S. S.. Kjo pasuri është blerë dhe regjistruar në emër të bashkëshortit pas martesës”*. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *të ardhurat personale të dy bashkëshortëve*. Për sa i përket vlerës së kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Vlera e blerjes në prill 2003 për pjesën e P. S. ishte 1.000.000 lekë [...], ndërsa në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të blerjes është rivlerësuar në vlerën 5.763.275 lekë [...]*”.

Lidhur me kontratën e premtim shitjes së vitit 2003, cituar më sipër, për sa i përket çmimit dhe mënyrës së likuidimit të shumës 1.950.000 lekë, subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se: *kjo pagesë është kryer me të ardhurat e vëllait të bashkëshortit S. S. , të cilët kishin rënë dakord me bashkëshortin e subjektit për blerjen e një trualli dhe ndërtimin e dy shtëpive më vete*. E pyetur nga Komisioni lidhur me deklarin periodik të vitit 2004, në të cilin është deklaruar sipërfaqja e truallit 175 m², në vlerën 1.000.000 lekë, subjekti ka sqaruar se kjo shumë ka qenë detyrim ndaj S. S. për pjesën takuese, dhe bashkëshorti e ka shlyer duke investuar në ndërtimin e themeleve/bodrumit, që i takonin pjesës së shtëpisë së S. S., duke qenë se në atë kohë ai jetonte në Mbretërinë e Bashkuar. Subjekti ka sqaruar se nuk disponon dokumente/fatura për blerjen e materialeve të ndërtimit dhe kryerjen e shërbimeve, si dhe nuk ka deklaruar një vlerë konkrete për punimet e kryera, e cila duhet të ketë qenë e konsiderueshme për ta deklaruar, pasi subjekti ka shpjeguar se ndërtimi i themeleve dhe karabinave është kryer njëherazi për të dyja shtëpitë private të banimit, duke filluar që nga viti 2003.

Unë, gjyqtare në pakicë, vlerësoj se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kontratën e premtim shitjes së vitit 2003, për likuidimin e shumës 1.950.000 lekë nga vëllai i bashkëshortit të saj dhe për punimet e kryera nga bashkëshorti, kanë mbetur në nivel deklarativ, pasi subjekti dështoi të provojë me dokumentacion provues, burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të vëllait të bashkëshortit S. S. , dhe kalimi i kësaj shume nëpërmjet transfertës bankare, nuk e bën atë një të ardhur të ligjshme. Gjithashtu, subjekti nuk provoi me

dokumentacion justifikues ligjor shpenzimet e kryera nga personi i lidhur, për hapjen e themeleve/bodromeve për dy shtëpitë private të banimit.

6. Lidhur me kontratën e shitjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2013, mes palëve kontraktuese – shitëse, S. H. si përfaqësues me prokurë të posaçme dhe palë blerëse, P. S. dhe S. S. – për pasurinë tokë *truall* me sipërfaqe 450 m², për të cilën, në nenin 3 të saj, palët kanë caktuar që çmimi i shitjes do të jetë 13.526.550 lekë, *shuma e sipërme është paguar e plotë prej blerësve, jashtë kësaj zyre dhe në këtë drejtim shitësit nuk kanë ndonjë pretendim për të parashtruar*. Në vijim të kësaj kontrate, në nenin 6 të saj, përcaktohet se *blerësit kanë paguar totalisht dhe jashtë kësaj zyre, shumën prej 13.526.550 lekësh, çmim ky sipas rivlerësimit bërë për këtë pasuri*.
7. Referuar kontratës së shitjes së vitit 2013, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave privatë të këtij viti, ka deklaruar: *Rivlerësim të truallit të tokës ku është ndërtuar shtëpia në proces legalizimi dhe formalizuar kontrata e shitblerjes të truallit (fillimisht me kontratë parablerjeje) – ½ e pjesës së truallit të blerë bashkë me S. S. . Vlera e pjesës takuese të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personi të lidhur, deklarohet në këtë deklaratë, në shumën 5.763.275 lekë*.
8. Shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit në Komision si: (i) *rritja e sipërfaqes prej 117 m² në deklaratën e shitjes 2013 ka ardhur si rezultat i sistemimit të truallit, që me nisjen e themeleve në vitin 2003, i cili prodhoi kosto të konsiderueshme (shumë më tepër seç ishte planifikuar) dhe për këtë pati dakordësi verbale me palën shitëse, që kur të formalizohej kontrata e shitjes të përfshihej sipërfaqja e shtuar pa rritur çmimin; (ii) çmimi i shitblerjes nuk ka ndryshuar (domethënë për këtë kontratë shitje pavarësisht se çfarë përmban kontrata, sipas subjektit çmimi është 1.950.000 lekë i pandryshuar), pavarësisht rritjes së sipërfaqes prej 117 m², pasi ky fakt ka qenë i parashikuar në kontratën e premtim shitjes, në rast të kundërt do të zbatoheshin sanksione kundrejt shitësve; (iii) çmimi i vendosur në kontratën e vitit 2013 është çmimi i rivlerësimit, çmoj se mbetën në nivel deklarativ*.
9. E vlerësoj të gabuar konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se: [...] *Deklarata noteriale e palëve nënshkruese të kontratës së shitblerjes së truallit, duket se është në harmoni me dokumentacionin justifikues ligjor të kohës, pra, përcaktimet e kontratës së shitblerjes, pamjet/fotografitë, si dhe ortofotot, duke krijuar bindjen për bazueshmërinë e pretendimit të subjektit. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se kontrata e shitblerjes së truallit, datë 02.09.2013, ka finalizuar respektimin e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e premtim shitjes të vitit 2003, si dhe marrëveshjen verbale të palëve për shtesën e sipërfaqes 117 m², pra, për kalimin të blerësit tashmë edhe në aspektin formal, të sipërfaqes totale të truallit prej 450 m², të cilën e posedonin prej vitit 2003, dhe mbi të cilin janë ndërtuar shtëpitë e tyre [...], pasi ka pranuar shpjegimet e subjektit lidhur me kontratën e shitjes, duke u bazuar kryesisht në deklaratat noteriale të hartuara dhe dorëzuara gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat nuk mund të prevalojnë për nga fuqia provuese, vlerën provuese të kontratës së shitjes. Referuar praktikës së konsoliduar tashmë të Kolegjit, deklaratat noteriale të lëshuara në periudhën e rivlerësimit janë konsideruar me rezervë sa i përket fuqisë së tyre provuese, pasi përveçse janë deklarative, së pari, depozitohen nga subjektet e rivlerësimit në mbështetje të shpjegimeve të dhëna prej tyre në kuadër të këtij procesi dhe, së dyti, palët kontraktore deklaruese në këto deklarata*

noteriale kanë pasur mundësinë që vullnetin e tyre ligjor ta shprehin në kohë, duke e formalizuar në kontratën e shitblerjes të vitit 2013.

10. E çmoj të gabuar përpjekjen e shumicës mbështetur në pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të lidhur kontratën e premtim shitjes së vitit 2003 me kontratën e shitjes së vitit 2013, pasi ato janë dy akte noteriale të pavarura nga njëra-tjetra, nisur nga përmbajtja e tyre. Në kontratën e shitjes 2013, **nuk** referohet në asnjë nen të saj kontrata e premtim shitjes së vitit 2003; blerësi i truallit në kontratën e premtim shitjes është vetëm bashkëshorti i subjektit, P. S., kurse në kontratën e shitjes 2013 është bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me vëllain e tij, S. S. ; sipërfaqja e truallit objekt shitjeje në kontratën e premtim shitjes 2003 është ekzaktësisht 333 m², ndërsa në kontratën e shitjes 2013, sipërfaqja e tokës objekt shitje është 450 m²; çmimi i truallit në kontratën e premtim shitjes 2003 është përcaktuar 1.950.000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes 2013 është 13.526.550 lekë.
11. Në vlerësimin tim, asgjë nuk i pengonte palët kontraktore, që në kushtet e kontratës së shitblerjes të vitit 2013, t'i referoheshin kontratës së premtim shitjes së vitit 2003, sa i përket çmimit të truallit dhe mënyrës së pagesës apo që shuma prej 13.526.550 lekësh, sipas rivlerësimit, ishte përcaktuar në këtë kontratë vetëm për efekt të detyrimit tatimor për kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e saj në regjistrat e ZVRPP-së, por përkundrazi në këtë kontratë përcaktohet se çmimi i shitjes së tokës *truall* do të jetë 13.526.550 lekë, dhe blerësit e kanë paguar totalisht dhe jashtë zyrës noteriale këtë shumë.
12. Unë, gjyqtare në mendim pakice, vlerësoj të pabazuar konkluzionin e arritur nga shumica e trupit gjykues, që shtesa prej 117 m² e sipërfaqes së truallit në kontratën e shitjes 2013, krahasuar me kontratën e premtim shitjes 2003, të jetë përfituar pa kundërshtim. Duket që shumica e trupit gjykues, në vlerësimin që i ka bërë kësaj pasurie, është mbështetur kryesisht në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat mbetën në nivel deklarativ, si dhe në deklaratat noteriale lëshuar gjatë procesit të rivlerësimit, duke i dhënë kështu përparësi kushteve të kontratës së premtim shitjes së vitit 2003, në raport me kontratën e shitblerjes të vitit 2013. Vlerësoj se është përtej logjikës ekonomike të pretendosh që pas dhjetë vitesh, pjesa e truallit të shtuar me 117 m² të përfitohet nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të njëjtin çmim sikurse në vitin 2003.
13. Po kështu, e gjej të padrejtë e të pabazuar konkluzionin e shumicës së trupit gjykues në vendim, *[...] në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se përsëri hipotetkisht kishte mundësi me burime financiare të ligjshme të paguante këtë sipërfaqe shtesë, si në vitin 2003 apo 2013 [...]*, pasi analiza financiare është kryer bazuar në sa deklaroi subjekti i rivlerësimit në deklaratat e saj dhe gjatë hetimit në Komision, dhe jo në sa provohet me dokumentacionin provues të administruar në dosjen gjyqësore.
14. Për gjithë sa arsyetuar më sipër, e vlerësoj të gabuar edhe analizën financiare të kryer nga Komisioni, i cili për të provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në vitin 2013, ka përllogaritur çmimin e pjesës takuese të tokës së përfituar nga bashkëshorti me kontratën e shitjes së vitit 2013, sikurse e deklaroi subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2013 dhe deklaratën e pasurisë *vetting*, duke pjesëtuar çmimin e shitjes përcaktuar në këtë kontratë 13.526.550 lekë për dy persona [13.526.550 lekë : 2

persona], dhe nga shuma e rezultuar 6.763.275 lekë për secilin blerës, ka zbritur vlerën 1.000.000 lekë të pretenduar të paguar sipas kontratë premtim shitje 2003, sikurse edhe e ka deklaruar në deklaratën periodike 2004. Zbritja e kësaj shume nga vlera e detyrimit bie ndesh dhe me sa vetë subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, ku ka deklaruar se nuk e ka paguar asnjëherë këtë shumë, pasi e ka shlyer me punimet e kryera, pretendime të cilat nga ana tjetër nuk i mbështet me dokumentacion provues.

15. Por edhe nëse e konsiderojmë të mirëqenë rezultatin financiar të analizës së Komisionit, diferencën negative në shumën (-) 3.408.493 lekë, në vitin 2013, për likuidimin e pjesës së truallit të blerë në këtë vit, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, kjo diferencë përfaqëson mungesë burimesh financiare të ligjshme në masë të konsiderueshme për t'u klasifikuar si pamjaftueshmëri në deklarin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit e që, për rrjedhojë, bën të zbatueshëm nenin 61, pika 3 të po këtij ligji. Për sa më sipër, çmoj se konkluzioni i shumicës së trupit gjykues se: "[...] subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë, kryer investime dhe shpenzime për vitin 2013. [...] subjekti i rivlerësimit ka arritur në nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, [...], është i gabuar.

Si përfundim, për mua gjyqtare në pakicë, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, çmoj se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për këtë kriter. Gjithashtu, mbështetur në sa analizuar më sipër, e çmoj alogjik faktin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar pasurinë truall, sipas kontratës së premtim shitjes së vitit 2003 dhe të kontratës së shitjes të vitit 2013, pa kundërshpërblim, sikurse ka pretenduar dhe është pranuar nga shumica.

Në lidhje me vendimin e pushimit të procedimit penal, datë 27.05.2014, të dosjes penale nr. {}, datë 11.09.2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë***

16. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, në lidhje me këtë procedim penal, ka rezultuar se: *Një shtetas anglez ka kallëzuar fakte penale ndaj shtetasit E. D. në lidhje me disa veprime të paligjshme të kryera nga ai gjatë kohës së ekzistencës së sipërmarrjes tregtare midis tyre, ku ka referuar midis të tjerave edhe disa fakte mitmarrjeje ku përfshihen zyrtarë të lartë si z. E. H. në lidhje me favorizimin për marrjen e licencës për krijimin e një resorti turistik në Kavajë.*
17. Në lidhje me këtë kallëzim, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore, ndër të cilat: (i) *kërkimin e informacionit në QKB në lidhje me regjistrimin e shoqërisë dhe gjendjen aktuale;* (ii) *kërkimin e informacionit nga banka për tërheqjen e shumës së parave nga shtetasi anglez;* (iii) *kërkimin e informacionit Ministrisë së Transporteve për pamjet filmike, ku zyrtari i lartë në kohën e referuar ka pasur detyrën e zëvendësministrit të kësaj ministrie;* (iv) *këqyrjen e librit të hyrje-daljeve të personave në Ministrinë e Jashtme për periudhën e referuar nga kallëzuesi, ku zyrtari i lartë ka pasur detyrën e Ministrit të kësaj ministrie;* (v) *marrjen në pyetje të shtetasve E. D. dhe E. H..* Në përfundim të këtyre veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal për veprën penale të mashtrimit ndaj shtetasit E. D. me arsyetimin se *nuk provohet ana objektive e veprës penale të mashtrimit.*

18. Sipas vendimit të Komisionit, nga analizimi i kryer për këtë çështje, u vërejtën disa gjetje, të cilat përqendroheshin kryesisht në evidentimin e qëndrimit pasiv të subjektit në drejtim të kryerjes së veprimeve të plota hetimore për zbardhjen e fakteve të tjera penale të referuara në kallëzim ndaj subjekteve të posaçëm, funksionarë të lartë të shtetit, fakte të cilat për nga rëndësia përfshihen në kategorinë e krimeve kundër autoritetit të shtetit, parashikuar në nenet 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë”, 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, dhe 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë” të Kodit Penal. Nisur nga rëndësia e këtyre veprave penale, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime në lidhje me: (a) *arsyet e mbylljes së hetimit vetëm në lidhje me veprën penale të mashtrimit për E. D., pa u shprehur kryesisht për veprimet e tjera penale, në të cilat referohen persona të tjerë, funksionarë të lartë të shtetit;* (b) *nëse gjatë kryerjes së hetimeve, e kishte kontaktuar shtetasin anglez, si kallëzues në cilësinë e prokurores së çështjes me qëllim për të marrë më shumë informacion nga ai në lidhje me faktet e referuara në kallëzim apo nëse kishte administruar mesazhet/komunikimet telefonike që mund të ketë pasur ai me shtetasin E. D., në lidhje me këto fakte;* (c) *nëse subjekti kishte identifikuar natyrën e marrëdhënies midis shtetasve E. D. dhe E. H. nisur nga faktet e kallëzuara;* (d) *se përse nuk e thirri si dëshmitar shtetasin e huaj të quajtur J.M., i cili referuar fakteve diktohet si personi që ka qenë prezent në një nga takimet e kryera me z. E. H.;* (e) *se përse nuk vlerësoi thirrjen e kallëzuesit dhe të kallëzuarve për ballafaqimin midis tyre në lidhje me rrethanat kontradiktore të konstatuara në hetim.*
19. Për sa sipër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, ndër të tjera, se pavarësisht regjistrimit të procedimit për veprën penale të mashtrimit, ajo ka kryer një sërë veprimesh hetimore, për të zbardhur faktet, dhe se pavarësisht se kanë ekzistuar indicie, dyshimi nuk ngrihej në nivelin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, duke përsëritur kështu të njëjtat veprime hetimore të evidentuara nga Komisioni. Në lidhje me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka theksuar se ka qenë prezent kur është pyetur shtetasi anglez, pavarësisht se procesverbali është mbajtur në emrin e oficerit të policisë gjyqësore, por është nënshkruar edhe nga vetë ajo. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se referuar deklarimeve të dhëna, shtetasit D. dhe H. kanë pranuar që të jenë takuar disa herë vetëm të tre bashkë me shtetasin anglez ose dhe me të tjerë në zyrën e ministrit, por se asnjëri prej tyre nuk ka pranuar faktet penale. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka theksuar se janë kryer të gjitha veprimet hetimore, pa u limituar në faktin penal të mashtrimit, por nga hetimi nuk ka rezultuar konsumimi i elementeve të ndonjë veprë penale.
20. Unë, gjyqtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmoj se subjekti i rivlerësimit lidhur me kallëzimin penal nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore për zbardhjen siç duhet të çështjes. Nga përmbajtja e kallëzimit penal nga shtetasi anglez, janë evidentuar faktet dhe personat ndaj të cilëve atribuohen veprat penale të *korruptionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë, dhe e ushtrimit dhe i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*. Veprimet hetimore kanë qenë të përcipta dhe jo të thelluara, për zbardhjen e çështjes siç duhet, për vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve përkatës. Çmoj se, me veprimet e mosveprimet e prokurores në këtë rast, dukshëm, rezulton tendencë e saj që personat e dyshuar mos të vihen përpara drejtësisë. Arrij në këtë përfundim, pasi kallëzimi penal ishte i qartë në përmbajtje dhe nuk kishte asnjë dyshim për emrat e

personave të përfshirë si të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Në gjykimin tim, në këtë rast, subjekti nuk duhet të vlerësohet sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, por si tendencë e subjektit të rivlerësimit për të favorizuar personat e caktuar, duke mos i vënë përpara përgjegjësisë ligjore për veprat penale të dyshuara.

*Në lidhje me vendimin e pushimit të procedimit penal, datë 09.10.2013, të dosjes penale nr. {***}, datë 14.12.2012, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë*

21. Ka rezultuar se disa qytetarë kanë bërë kallëzim penal ndaj mjekut E. P., kardiolog me detyrën e Shefit të Shërbimit të Kardiologjisë së {***} “{***}”, në të cilin kallëzojnë se për kryerjen e operacioneve, ky mjek u kërkonte para. Në lidhje me këtë procedim, rezultoi se subjekti ka kryer disa veprime hetimore dhe në përfundim ka vendosur pushimin e procedimit penal.
22. Nga përmbajtja e akteve shkresore të administruara në kuadër të këtij procedimi nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet hetimore për zbardhjen siç duhet të çështjes penale, në ngarkim të mjekut kardiolog. Referuar deklaramente të shtetasve, konstatohet se ka pasur mospërputhje për fakte e rrethana të caktuara me ato të dhëna prej mjekut E. P.. Subjekti duhet të kishte kryer veprimet hetimore të ballafaqimit të tyre, bazuar në nenin 169 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, në aktet e administruara, referohet emri i kryeinfermieres nga dy kallëzuesit si person/ndërmjetës me mjekun, dhe nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ndërmarrë ndonjë veprim procedural për identifikimin e gjeneraliteteve të kryeinfermieres, e cila referohet në kallëzim, si dhe ta thërrasë në pyetje këtë shtetase në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e faktit.

Lidhur me kohëzgjatjen e veprimeve hetimore, konstatohet se nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi ka kaluar një afat kohor rreth 10 muaj. Nga analizimi i dosjes, në lidhje me kohëzgjatjen e veprimeve hetimore, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit penal në ngarkim të mjekut E. P. në datën 14.12.2012, ka urdhëruar policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilat kanë vijuar për një periudhë 3 (tre) muajore. Rezulton se prej muajit prill të vitit 2013 deri në datën 23.09.2013, kur është hartuar relacioni me sugjerimin mbi përfundimin e hetimit, nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga subjekti i rivlerësimit. Konstatohet se subjekti ka vijuar të kryejë veprime hetimore jashtë afatit procedural, parashikuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale, dhe nuk ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve.

Në lidhje me njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka disponuar në vendim për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara, por ky vendim nuk duket se i është njoftuar palëve, pasi në fashikullin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2012, nuk rezulton të ketë njoftim në formën e kërkuar nga ligji procedural penal.

23. Subjekti në shpjegimet e dhëna ka pretenduar se ka kryer veprimeve procedurale, që nga regjistrimi i procedimit e në vijim autorizimi i oficerëve të policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve vëzhguese ndaj mjekut, marrjen në pyetje të personave të referuar në kallëzim e deri tek autorizimi për një periudhë të caktuar për kryerjen e përgjimeve ambientale. Subjekti, pas relatimit të këtyre veprimeve, ka shpjeguar se nga analiza e tyre nuk u arrit të provohej që mjeku të ketë kryer veprime të natyrës korruptive. Në lidhje me konstatimin mbi kalimin e afateve procedurale të hetimit, subjekti pretendoi se nuk ka pasur tejkalim të afateve, pasi

vendimi është marrë pas administrimit të relacionit të policisë gjyqësore mbi mënyrën e përfundimit të çështjes penale. Ndërsa në lidhje me mosnjoftimin e vendimit ndaj palëve, subjekti ka shpjeguar se vendimi nuk u është njoftuar palëve, duke arsyetuar se ka pasur parasysh faktin se procedimi penal është regjistruar mbi bazën e informacionit të referimit të paraqitur kryesisht nga Drejtoria e Policisë Tiranë, dhe se hetimi dhe relacioni për pushimin e procedimit ishte bërë nga oficeri i policisë gjyqësore, që kishte referuar materialin kallëzues.

24. Unë, gjyqtare në pakicë, çmoj se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore shteruese për zbardhjen e fakteve penale ndaj mjekut E. P.. Nga analiza e fakteve në raport me veprimet hetimore të kryera nga subjekti, duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë pasiv për kryerjen e veprimeve të duhura hetimore. Gjithashtu, subjekti nuk justifikon faktin mbi arsyet e zgjatjes së afatit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, si dhe mbi mosmarrjen e vendimit për zgjatje afati, sikurse kërkohet nga legjislacioni procedural penal.

Lidhur me mosnjoftimin e palëve për vendimin e pushimit, çmoj të pabazuar pretendimin e subjektit që përgjegjësitë e saj ligjore ia ngarkon oficerit të policisë gjyqësore, për arsye se është prokurori i cili ka kompetencë funksionale regjistrimin, disponimin me vendim në lidhje me hetimet e çështjes, si dhe detyrimin për njoftimin e palëve në lidhje me vendimin përfundimtar, ndërsa oficeri i policisë gjyqësore kryen veprimet hetimore në zbatim të urdhrin të prokurorit të çështjes.

25. Unë, gjyqtare në pakicë, në analizë të këtyre dy procedimeve penale, në konsideratë të rëndësisë dhe zbardhjes së plotë të tyre, nisur nga fakti që lidhen me vepra penale me rrezikshmëri, që reflektojnë problematika aktuale në vendin tonë, konstatoj se subjekti i rivlerësimit nuk është thelluar siç duhet në hetimin e këtyre çështjeve, mungesa e veprimeve hetimore vë në dyshim serioz thelbin e vendimmarrjes së prokurores, për akuzat e personave të përfshirë në këto procedime, duke mos i vënë ata përpara përgjegjësisë penale dhe duke cenuar, në këtë mënyrë, besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

26. Lidhur me sa më sipër, vlerësoj se vendimi i Komisionit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duhet të lihet në fuqi dhe vlerësimi i bërë nga shumica e trupit gjykues, për këtë çështje, ka qenë sipërfaqësor, i gabuar dhe i pambështetur në ligj dhe në fakte ligjore.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi